



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 15 korrik 2024
Nr. ref.: MK 2477/24

MENDIM KONKURRUES DHE MOSPAJTUES

i gjyqtarit

RADOMIR LABAN

në

rastet e bashkuara nr. KO114/23, KO192/23, KO227/23 dhe KO229/23

Parashtrues

Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së paragrafit 2 të nenit 4, paragrafit 4 të nenit 432,
dhe paragrafit 2 të nenit 438 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së
Kosovës nr. 08/L-032**

Duke shprehur në fillim respektin tim për mendimin e shumicës së gjyqtarëve në këtë rast, në të cilin Gjykata ka konstatuar si më poshtë:

- I. TË DEKLAROJË, njëzëri, kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË, njëzëri, se formulimi “ose ndërprerjen” i paragrafit 4 të nenit 432 (Arsyet për paraqitje së kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë) të Kodit nr. 08/L-032 të Procedurës Penale, nuk është në kundërshtim me pikën 2 të paragrafit 1 të nenit 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës në lidhje me nenin 5 (E drejta për liri dhe siguri) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- III. TË KONSTATOJË, njëzëri, se paragrafi 2 i nenit 4 (Ne Bis In Idem) i Kodit nr. 08/L-032 të Procedurës Penale nuk është në kundërshtim me nenin 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 2 të nenit 4 (E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë) të Protokollit nr. 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- IV. TË KONSTATOJË, me (5) vota për dhe (4) kundër, se formulimi “përveç nëse vendimi i formës së prerë është qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë” i paragrafit 2 të nenit 438 (Aktgjykimi mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë) i Kodit nr. 08/L-032 të Procedurës Penale, nuk është në kundërshtim me nenin 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 2 të nenit 4 (E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë) të Protokollit nr. 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

Si gjyqtar, plotësisht pajtohem me mendimin e shumicës së gjyqtarëve në këtë rast me paragrafin I të këtij aktgjykimi se rasti është i pranueshëm për shqyrtim.

Më tej, unë, si gjyqtar, pajtohem me dispozitivin e paragrafit II dhe paragrafit III të aktgjykimit, por nuk pajtohem me analizën ligjore dhe arsyetimin e këtyre paragrafëve dhe do të paraqes mendimin tim konkurrues në lidhje me ta.

Në të njëjtën kohë, nuk pajtohem me dispozitivin e paragrafit IV si dhe me analizën ligjore dhe arsyetimin e të njëjtit dhe do të paraqes mendimin tim mospajtues në lidhje me pikën IV.

Si gjyqtar pajtohem plotësisht me gjendjen faktike siç është deklaruar dhe paraqitur në aktgjykim dhe e pranoj të njëjtën gjendje faktike si të saktë. Gjithashtu, pajtohem me mënyrën se si janë parastruar dhe paraqitur në aktgjykim pretendimet e parastruesit të kërkesës, si dhe komentet e palëve të ndryshme të interesuara.

Për sa më sipër, dhe në pajtim me rregullat 56 dhe 57 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese, do të paraqes mendimin tim konkurrues dhe mospajtues me shkrim.

Për sa më sipër, me qëllim të ndjekjes sa më të lehtë dhe të qartë dhe arsyetimit të mendimit Tim konkurrues dhe mospajtues, do të arsyetoj hollësisht **(A)** Meritat e kërkesës **(B)** Vlerësimin e kushtetutshmërisë së dispozitave përkatëse të ligjit të kontestuar në kontekst të paraburgimit - rastet e bashkuara KO114/23 dhe KO227/23 **(C)** Të bëjë vlerësimin e kushtetutshmërisë së paragrafit 4 të nenit 432 të ligjit të kontestuar **(D)** Të paraqes kontekstin e rasteve të bashkuara KO192/23 dhe KO229/23 ku zbatohet parimi “ne bis in idem” **(E)** Të paraqes Parimet e përgjithshme në lidhje me institutin juridik Ne bis in idem bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së **(F)** Të bëjë vlerësimin e kushtetutshmërisë së paragrafit 2 të nenit 4 (Ne Bis In Idem) në kontekst të hedhjes poshtë të aktakuzës, përkatësisht ndryshimit të vendimit të formës së prerë, përmes të cilit përmbillet procedura penale në rastet e bashkuara KO192/23 dhe KO229/23. **(G)** Të bëjë vlerësimin e kushtetutshmërisë së paragrafit 2 të nenit 438 (Aktgjykimi mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë) në kontekst të hedhjes poshtë të aktakuzës, përkatësisht ndryshimit të vendimit të formës së prerë, përmes të cilit përmbillet procedura penale në rastet e bashkuara KO192/23 dhe KO229/23 **(H)** Të paraqes përfundimin në lidhje me shkeljet e pretenduara të Kushtetutës.

A) Meritat e kërkesës

1. Rikujtoj se Gjykata referuese gjatë shqyrtimit të rasteve konkrete ka ngritur dyshime për papajtueshmërinë e paragrafit 2 të nenit 4 (Ne Bis In Idem), paragrafi 4 i nenit 432 (Arsyet për paraqitje së kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë) dhe paragrafi 2 i nenit 438 (Aktgjykimi mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë) të Ligjit të kontestuar, me nenet 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë], 34 [E drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër] dhe 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës.
2. Verësoj se për vlerësimin e kushtetutshmërinë së dispozitave përkatëse të Ligjit, së pari duhet sqaruar bazën ligjore lidhur me të drejtën e Prokurorit të Shtetit për të paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në dëm të të pandehurit në rastet e paraburgimit, kundërshtimit të provave dhe hudhjes së aktakuzës dhe aktgjykimit të formës së prerë me të cilin përfundohet procesi penal.
3. Në këtë kontekst, vërej se paragrafi 2 i nenit 4 (Ne Bis In Idem) të Ligjit të kontestuar përcakton: (i) *2. Me përjashtim të rasteve kur me këtë Kod është paraparë ndryshe, vendimi gjyqësor i formës së prerë mund të ndryshohet me mjete të jashtëzakonshme juridike;* (ii) paragrafi 4 i nenit 432 (Arsyet për paraqitje së kërkesës për mbrojtje të

ligjshmërisë) i Ligjit të kontestuar përcakton: (ii)4. *Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqitet, gjatë procedurës e cila nuk ka përfunduar në formë të prerë, vetëm kundër vendimeve të formës së prerë lidhur me caktimin, vazhdimin ose ndërprerjen e paraburgimit.*(iii) paragrafi 2 i nenit 438 (Aktgjykimi mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë) i Ligjit të kontestuar përcakton: 2. *Kur Gjykata Supreme e Kosovës çmon se kërkesa e paraqitur për mbrojtjen e ligjshmërisë në dëm të të pandehurit është e bazuar, vetëm konstaton shkeljen e ligjit pa ndikuar në vendimin e formës së prerë, përveç nëse vendimi i formës së prerë është qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë.*

4. Po ashtu, vlerësoj se neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës do të merret parasysh nga Gjykata vetëm nëse kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga Prokurori i Shtetit kundër ndërprerjes së paraburgimit, kundërshtimit të provave dhe hudhjes së aktakuzës dhe aktgjykimit të formës së prerë me të cilin përfundohet procesi penal është apo nuk është në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm GJEDNJ).
5. Në këtë kontekst, vlerësoj se objekt vlerësimi kushtetues në këtë kërkesë është paragrafi 2 i nenit 4 (Ne Bis In Idem) i ligjit të kontestuar përcakton: (i) 2. *Me përjashtim të rasteve kur me këtë Kod është paraparë ndryshe, vendimi gjyqësor i formës së prerë mund të ndryshohet me mjete të jashtëzakonshme juridike;* (ii) paragrafi 4 i nenit 432 (Arsyet për paraqitje së kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë) përcakton: 4. *Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqitet, gjatë procedurës e cila nuk ka përfunduar në formë të prerë, vetëm kundër vendimeve të formës së prerë lidhur me caktimin, vazhdimin ose ndërprerjen e paraburgimit;* (iii) paragrafi 2 i nenit 438 (Aktgjykimi mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë) përcakton: 2. *Kur Gjykata Supreme e Kosovës çmon se kërkesa e paraqitur për mbrojtjen e ligjshmërisë në dëm të të pandehurit është e bazuar, vetëm konstaton shkeljen e ligjit pa ndikuar në vendimin e formës së prerë, përveç nëse vendimi i formës së prerë është qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë,* përkatësisht nëse këto të fundit janë pajtim me të drejtat e njeriut të garantuara me nenet 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] dhe 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 5 (E drejta për liri dhe siguri) dhe nenin 4 (2) (E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë) të Protokollit nr. 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).
6. Theksoj se kërkesat e bashkuara KO114/23, KO192/23, KO227/23 dhe KO229/23 do të vlerësohen bazuar në karakteristikat tyre. Në këtë kontekst, vërej se kërkesat e bashkuara KO114/23 dhe KO227/23 janë çështje të paraburgimit që do të vlerësohen vetëm në kuptim të nenit 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës në lidhje me nenin 5 (E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë) të KEDNJ-së.
7. Në anën tjetër, kërkesat e bashkuara KO192/23 dhe KO229/23 kanë të bëjnë me kundërshtim të provave dhe hedhje të aktakuzës përkatësisht vendim të formës së prerë me të cilin përfundon procesi penal. Rrjedhimisht, theksoj se kërkesat e bashkuara KO192/23 dhe KO229/23 do të vlerësohen në kontekst të parimit *ne bis in idem* siç garantohet me nenin 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër] të Kushtetutës në lidhje me nenin 4 (2) (E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë) i Protokollit Nr. 7 të KEDNJ-së.
8. Po ashtu, sqaroj se në pajtim me nenin 53 (Vendimi) të Ligjit, vendos vetëm për pajtueshmërinë e dispozitës ligjore me Kushtetutën dhe nuk vendos për çështje të tjera faktike ose juridike që kanë të bëjnë me kontestin para Gjykatës referuese. Thënë ndryshe, vlerësoj vetëm nëse dispozita ligjore e kontestuar është në përputhshmëri me normën

kushtetuese. Po ashtu, rikujtoj se i takon Gjykatës referuese të aplikojë konstatimin e Gjykatës në rrethanat e rastit që ka para vetes.

9. Në tekstin në vijim, para se të vlerësoj kushtetutshmërinë e dispozitave përkatëse të Ligjit të kontestuar do të reflektoj: **(i)** Sfondin e ligjit procedural penal; **(ii)** Parimi i sigurisë juridike nga jurisprudenca e konsoliduar e GJEDNJ-së; dhe Komisionit të Venecias.

Sfondi i ligjit procedural penal

10. Vlerësoj se në këtë kontekst është e nevojshme të pasqyrohen dispozitat përkatëse të ligjeve procedurale penale të cilat kanë qenë pararendëse të Ligjit të kontestuar në mënyrë që të jepet një kontekst më i përgjithshëm lidhur me paraburgimin, mjetet e jashtëzakonshme juridike dhe të drejtat e të pandehurit në procedurë penale.
11. Nga sa më sipër, vërej se (i) paragrafi 4 i nenit 432 (Arsyet për paraqitje së kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë) i Kodit nr. 04/L-123 i shfuqizuar nga Ligji i kontestuar parashikonte që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqitet kundër vendimeve të formës së prerë lidhur me caktimin ose vazhdimin e paraburgimit; (ii) neni 441 (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut) i Kodit nr. 04/L-123 i shfuqizuar nga Ligji i kontestuar parashikonte që kërkesa për mjet të jashtëzakonshëm mund të paraqitet në bazë të të drejtave të siguruara me këtë Kod dhe të mbrojtura me Kushtetutë, KEDNJ si dhe me vendimet e GJEDNJ-së; (iii) paragrafi 4 i nenit 451 (Pa titull) i Kodit të Përkohshëm i Procedurës Penale i Kosovës UNMIK/RREG/2003/26 i shfuqizuar me Kodin nr. 04/L-123 i Procedurës Penale parashikonte që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqitet kundër vendimeve të formës së prerë lidhur me caktimin ose vazhdimin e paraburgimit; (iv) neni 460 (Pa titull) i Kodit të Përkohshëm i Procedurës Penale i Kosovës UNMIK/RREG/2003/26 i shfuqizuar me Kodin nr. 04/L-123 i Procedurës Penale parashikonte që kërkesa për mjet të jashtëzakonshëm juridik sipas këtij kapitulli mund të paraqitet në bazë të vendimit të GJEDNJ-së në pajtim me procedurat që do të rregullohen me ligj.
12. Bazuar në paragrafin e shtjelluar më lart, rikujtoj se ligjet e procedurës penale pararendëse të Ligjit të kontestuar **(i)** në rastet e paraburgimit kanë lejuar përdorimin e mjetit të jashtëzakonshëm por vetëm në dobi të të pandehurit përkatësisht vetëm lidhur me vendimet me të cilat caktohej apo vazhdohej paraburgimi por jo edhe kundër vendimeve me të cilat ndërpritej paraburgimi; **(ii)** kërkesa për mjet të jashtëzakonshëm mund të paraqitet në bazë të të drejtave të siguruara me ligj procedural penal dhe të mbrojtura me Kushtetutë, KEDNJ si dhe me vendimet e GJEDNJ-së.
13. Vërej se për dallim prej ligjeve procedurale penale pararendëse, Ligji i kontestuar përkatësisht paragrafi 4 i nenit 432 (Arsyet për paraqitje së kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë) përcakton se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqitet kundër vendimeve të formës së prerë lidhur me caktimin, vazhdimin ose ndërprerjen e paraburgimit përkatësisht lejon që ky mjet i jashtëzakonshëm mund të përdoret në dëm të të pandehurit kundër vendimit për ndërprerjen e paraburgimit të të njëjtit.
14. Vërej se si pikë të përbashkët ligjet procedurale pararendëse dhe Ligji i kontestuar vënë në përdorim **(i)** parimin e prezumimit të pafajësisë të të pandehurit *in dubio pro reo* duke përcaktuar se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas ligjit procedural penal dhe Kushtetutës (shih nenin 3 të Kodit Nr. 04/L-123 të Procedurës Penale dhe nenin 4 të Ligjit të kontestuar); dhe, se **(ii)** kërkesa për mjet të jashtëzakonshëm mund të paraqitet në bazë të të drejtave të siguruara me ligj procedural penal dhe të mbrojtura me Kushtetutë, KEDNJ si dhe me vendimet e GJEDNJ-

së (shih nenin 441 të Kodit Nr. 04/L-123 të Procedurës Penale dhe nenin 440 të Ligjit të kontestuar).

Parimi i sigurisë juridike nga praktika e konsoliduar gjyqësore e GJEDNJ-së dhe Komisionit të Venecias

15. Kurdo që bëhet fjalë për mohim të lirisë është posaçërisht e rëndësishme që parimi i përgjithshëm i sigurisë juridike të përmbushet. Prandaj është thelbësore që kushtet e mohimit të lirisë të definoohen qartazi sipas të drejtës vendore dhe që vet ligji të jetë i parashikueshëm në zbatim, ashtu që e përmbush standardin e “ligjshmërisë” të përcaktuar me KEDNJ, një standard që kërkon që krejt ligjet të jenë mjaftueshëm të sakta që t’i lejojnë personit-nëse ka nevojë, me këshillë të duhur-të parashikojë, në një masë të arsyeshme të rrethanave, pasojat që veprimi i caktuar mund t’i sjellë (shih rastet e GJEDNJ-së, [Khlaifia dhe tjerët kundër Italisë](#), nr. 16483/12, Aktgjykim i 15 dhjetorit 2016, paragrafi 92; dhe [Del Río Prada kundër Spanjës](#), nr. 42750/09, Aktgjykim i 21 tetorit 2013, paragrafi 125).
16. Prandaj, Neni 5 (1) i KEDNJ-së nuk i referohet thjesht ligjit vendor, i njëjti po ashtu ndërlidhet me “cilësinë e ligjit” çka nënkupton se aty ku ligji vendor autorizon mohimin e lirisë i njëjti duhet të jetë mjaftueshëm i qasshëm, preciz dhe i parashikueshëm në zbatim. Faktorët relevant në vlerësimin e “cilësisë së ligjit”-që në disa raste i referohen si “masa mbrotjëse kundër arbitraritetit”- çka do të përfshijë ekzistencën dispozitive ligjore të qarta për të urdhëruar paraburgimin, për zgjatjen e paraburgimit, dhe për caktimin e afatit për paraburgim; si dhe ekzistencën e mjetit efektiv juridik me çka ankuesi mund të kontestojë “ligjshmërinë” dhe “kohëzgjatjen” e paraburgimit të tij (shih rastin e GJEDNJ-së, [J.N. kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 37289/12, Aktgjykim i 19 majit 2016, paragrafi 77). Për shembull, praktika e mbajtjes së personit në paraburgim bazuar në akt-akuzë pa ndonjë bazë specifike në legjislacionin vendor apo praktikë gjyqësore është në shkelje të nenit 5 (1) të KEDNJ-së (shih rastin e GJEDNJ-së, [Baranowski kundër Polonisë](#), nr. 28358/95, Aktgjykim i 28 marsit 2000, paragrafët 50-58). Njëlloj, praktika e përtëritjes automatike të paraburgimit në fazë para gjykimit pa ndonjë bazë precize ligjore është në kundërshtim me nenin 5 (1) të KEDNJ-së (shih rastin e GJEDNJ-së, [Svipsta kundër Letonisë](#), nr. 66820/01, Aktgjykim i 9 marsit 2006, paragrafi 86).
17. Veç kësaj, çdo mohim i lirisë duhet të jetë në pajtim me qëllimin e mbrojtjes së individit nga arbitrariteti (shih rastin e GJEDNJ-së, [S., V. dhe A. kundër Danimarkës](#), nr. 35553/12, 36678/12 and 36711/12, Aktgjykim i 22 tetorit 2018, paragrafi 74). Nocioni i “arbitraritetit” në nenin 5 (1) të KEDNJ-së zgjatet përtej mungesës së pajtimit me të drejtën vendore, ashtu që mohimi i lirisë mund të jetë i ligjshëm sa i përket të drejtës vendore por prapëseprap arbitrar dhe rrjedhimisht në kundërshtim me KEDNJ-në (shih rastet e GJEDNJ-së, [Creangă kundër Rumanisë](#), nr. 29226/03, Aktgjykim i 23 shkurtit 2012, paragrafi 84; dhe [A. dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 3455/05, Aktgjykim i 19 shkurtit 2009, paragrafi 164).
18. Përderisa vendimet gjyqësore përcaktojnë, shtjellojnë dhe qartësojnë ligjin, qasshmëria e tyre është pjesë e sigurisë juridike. Kufizimet mund të justifikohen në mënyrë që të mbrohen të drejtat individuale, për shembull të drejtat e të miturve në rastet penale. (CDL-PI(2022)004 Përmbledhje e Opinioneve dhe Raporteve të Komisionit të Venecias lidhur me Sigurinë Juridike, paragrafi 57).
19. Parashikueshmëria në kupton jo vetëm se ligji duhet, aty ku është e mundur, të shpallet para se të zbatohet dhe të jetë i parashikueshëm për sa i përket efektive të tij: ligji po ashtu duhet të formulohet me precizitet dhe qartësi të mjaftueshme ashtu që subjekteve ligjor t’ua mundësojë përshtatjen e sjelljes së tyre në pajtim me ligjin. (CDL-PI(2022)004, Përmbledhje e Opinioneve dhe Raporteve të Komisionit të Venecias lidhur me Sigurinë Juridike, paragrafi 58).

20. *Res judicata* nënkupton se kur një ankesë është gjykuar përfundimisht, ankesat e mëtejme nuk janë të mundura. Aktgjykimet e formës së prerë duhet të respektohen, përveç nëse ka arsye bindëse për rishikimin e tyre. (CDL-PI(2022)004 Përmbledhje e Opinioneve dhe Raporteve të Komisionit të Venecias lidhur me Sigurinë Juridike, paragrafi 63).
21. Sa i përket sigurisë juridike, Komisioni i Venecias ka vërejtur se është “thelbësore për besimin në sistemin gjyqësorë dhe sundimin e ligjit”, çka “kërkon që rregullat ligjore të jenë të qarta dhe precize, dhe se kanë për qëllim që situatat dhe marrëdhëniet ligjore të mbesin të parashikueshme. Retroaktiviteti bie ndesh me parimin e sigurisë juridike, të paktën në të drejtën penale (neni 7 KEDNJ), pasi që subjektet e ligjit duhet t’i dinë pasojat e sjelljes së tyre; por edhe në të drejtën civile dhe administrative për aq sa negativisht i prek të drejtat dhe interesat ligjore. (CDL-AD(2014) 021 Opinion i Komisionit të Venecias mbi draft-ligjin për amendamentet dhe shtesat në kodin gjyqësor të Armenisë, paragrafi 18).

B) Vlerësimi kushtetues i dispozitave përkatëse të Ligjit të kontestuar në kontekst të paraburgimit-rastet e bashkuara KO114/23 dhe KO227/23

22. Si pyetje paraprake në lidhje me vlerësimin e kushtetutshmërisë së dispozitave të ligjit të kontestuar në kontekst të paraburgimit - në rastet e bashkuara KO114/23 dhe KO227/23, vlerësoj se neni 4 [Ne Bis In Idem] i ligjit të kontestuar në lidhje me nenin 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër] paraqesin çështje që janë jashtë objektit të vlerësimit të kushtetutshmërisë të këtyre kërkesave të bashkuara sepse është e qartë se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e parashtruar nga prokurori i shtetit në këto dy kërkesa të bashkuara nuk i referohet hetimit, akuzës apo gjykimit të ri ndaj të pandehurit, por vetëm kundër vendimeve të formës së prerë që kanë të bëjnë me caktimin, vazhdimin dhe ndërprerjen e paraburgimit.
23. Në këtë kontekst, vlerësoj se objekt i vlerësimit kushtetues të dispozitave të ligjit të kontestuar në kuadër të paraburgimit në rastet e bashkuara KO114/23 dhe KO227/23 është paragrafi 4 i nenit 432 (Arsyet për paraqitje të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë) të ligjit kontestuar nëse të njëjtit janë në pajtim me parimin e sigurisë juridike, siç kuptohet dhe garantohet me nenin 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës në lidhje me nenin 5 (E drejta për liri dhe siguri) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ)

C) Vlerësimi i kushtetutshmërisë i paragrafit 4 të nenit 432 të Ligjit të kontestuar

24. Rikujtoj se paragrafi 4 i nenit 432 (Arsyet për paraqitje të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë) i Ligjit të kontestuar përcakton: “4. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqitet, gjatë procedurës e cila nuk ka përfunduar në formë të prerë, vetëm kundër vendimeve të formës së prerë lidhur me caktimin, vazhdimin ose ndërprerjen e paraburgimit.”
25. Më tej, rikujtoj se kërkesa për drejtësi procedurale që rrjedh nga neni 5 par. 4 nuk vendos obligimin që të zbatohen kriteret uniforme e të pandryshueshme, të pavarura nga konteksti, nga faktet dhe nga rrethanat. Ndonëse procedura që lidhet me nenin 5 par. 4 nuk duhet të shoqërohet gjithmonë me garanci të njëjta si ato që kërkohen nga neni 6 për procedurat civile ose penale, ajo duhet të ketë një karakter gjyqësor dhe t’i ofrojë individit të interesuar garanci të përshtatura sipas natyrës së heqjes së lirisë për të cilën ai ankohet (A. me të tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar [DHM], par. 203; Idalov k. Ruisë [DHM], par. 161).

26. Për çdo person ndalimi i të cilit i takon fushës së zbatimit të nenit 5 par. 1 c), kërkohet patjetër një seancë (Nikolova k. Bullgarisë [DHM], par. 58). Mundësia e një personi të privuar nga liria për t'u dëgjuar vetë personalisht ose përmes përfaqësuesit është një nga garancitë themelore procedurale përkitazi me çështjet në lidhje me heqjen e lirisë (Kampanis k. Greqisë, par. 47). Megjithatë, neni 5 par. 4 nuk kërkon që një i ndaluar të dëgjohej sa herë që ai paraqet ankesë kundër vendimit përmes të cilit vazhdohet heqja e tij e lirisë, por ai duhet të ketë mundësinë që ta ushtrojë në intervale të arsyeshme të drejtën për t'u dëgjuar (Çatal k. Turqisë, par. 33; Altınok k. Turqisë, par. 45).
27. Procedura duhet të ketë karakter diskutimi dhe të sigurojë në të gjitha rastet "barazinë e armëve" midis palëve (Reinprecht k. Austrisë, par. 31; A. me të tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar [DHM], par. 204). Në rastet që kanë të bëjnë me paraburgim, duke pasur parasysh se ekzistenca e vazhdueshme e dyshimit të bazuar se personi i akuzuar ka kryer një vepër penale është një kusht *sine qua non* për ligjshmërinë e vazhdimin të paraburgimit, atij duhet t'i jepet mundësia që të kontestojë në mënyrë efektive bazueshmërinë e pretendimeve të paraqitura kundër tij. Kjo kërkesë mund ta detyrojë gjykatën që të dëgjojë ata dëshmitarë dëshmia e të cilëve do të mund të ndikonte ligjshmërinë e mëtejshme të paraburgimit (Türcan k. Moldavisë, par. 67-70).
28. Barazia e armëve nuk garantohet në qoftë se parashtruesit të kërkesës, ose përfaqësuesit të tij, i refuzohet qasja te ato dokumente të shkresave hetimore të cilat janë thelbësore për të kundërshtuar në mënyrë efektive ligjshmërinë e paraburgimit (Ovsjannikov k. Estonisë, par. 72; Fodale k. Italisë; Korneykova k. Ukrainës, par. 68). Gjithashtu, mund të jetë e nevojshme që personi në fjalë të ketë jo vetëm mundësinë për t'u dëgjuar personalisht, por edhe që ai të përfitojë nga ndihma efektive e avokatit të tij (Cernák k. Sllovakisë, par. 78).
29. Parimet e procedurës së diskutimit dhe të barazisë së armëve duhet të respektohen në mënyrë të barabartë në procedurën para një gjykate të apelit (shih par. 33-34 në raastin Çatal k. Turqisë, dhe çështjet që citohen aty).
30. Vlerësoj se nga përgjigjet e pranuar nga gjykatat e shteteve anëtare të Forumit të Komisionit të Venecias rezulton-varësisht nga rregullimi ligjor i shtetit përkatës se: (i) Prokurori fare nuk ka në dispozicion mjet të jashtëzakonshëm për t'i kontestuar vendimet përfundimtare të gjykatave të rregullta; (ii) Prokurori mund të paraqes vetëm mjet të zakonshëm juridik gjatë zhvillimit të procedurës; dhe, (iii) edhe në sistemet juridiko-ligjore që i mundësojnë Prokurorit që të përdorë mjete të jashtëzakonshme juridike, gjykatat nxjerrin vetëm vendime të karakterit deklarativ nëse kërkesa është e bazuar, por nuk e ndryshojnë vendimin në dëm të të pandehurit. (Për shembull: i) në sistemin juridik shqiptar nuk ekziston mjeti i jashtëzakonshëm kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë që nga viti 1997; (ii) në sistemin juridik suedez nuk ka kërkesë për një mjet juridik të jashtëzakonshëm për të mbrojtur ligjshmërinë dhe që në praktikë rastet e paraburgimit të kontestohen gjithmonë me mjete të rregullta ligjore; (iii) në sistemin juridik të Lihtenshtajnit, ankimi në Gjykatën e Lartë lejohet në kontekstin e mjetit të zakonshëm juridik, ndërkohë që nuk ka asnjë mjet të jashtëzakonshëm të ngjashëm me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë; (iv) në sistemin juridik sllovak, Gjykata e Lartë mund të anulojë vendimet e paraburgimit të nxjerra në favor të të akuzuarit, por kjo çështje nuk është kontestuar asnjëherë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës Sllovaqe; (v) në sistemin juridik austriak, Prokurori i Përgjithshëm mund të paraqesë ankesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, e cila mund të nxjerrë një vendim të natyrës deklarative që konstaton shkelje të ligjit, por vendimi i Gjykatës Supreme asnjëherë nuk mund të ndryshohet në dëm të të pandehurit; (vi) sistemi juridik i Republikës Çeke nuk parashikon një mjet juridik të jashtëzakonshëm siç është kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë; (vii) Kazakistani u përgjigj se kategoria e mbrojtjes së jashtëzakonshme të ligjshmërisë nuk është shqyrtuar nga Gjykata Kushtetuese e Kazakistanit; (viii) në sistemin juridik kroat, Prokurori mund të paraqesë kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, por Gjykata Supreme

mund të nxjerrë vendim për shkeljen e ligjshmërisë por pa cenuar të drejtat e të pandehurit; (ix) në sistemin juridik turk, Prokurori nuk ka mundësi të paraqesë ankesë të jashtëzakonshme në Gjykatën e Kasacionit në lidhje me përfundimin e paraburgimit të të pandehurit; (x) sistemi juridik gjerman nuk përmban mjet të jashtëzakonshëm juridik që korrespondon me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë në rastet që kanë të bëjnë me paraburgimin; (xi) sistemi juridik i Maqedonisë së Veriut ka një mjet të jashtëzakonshëm juridik dhe mund të ngrihet kundër të akuzuarit, por Gjykata Supreme mund të konstatojë vetëm shkelje të ligjit, por nuk do të ndërhyjë në vendimin përfundimtar).

31. Më tej, rikujtoj se është e paimagjinueshme që, në një shtet të së drejtës, një individ të mbetet i privuar nga liria e tij ndonëse ekziston një vendim gjyqësor që urdhëron lirimin e tij (Assanidzé k. Gjeorgjisë [DHM], par. 173). Megjithatë, Gjykata, pranon njëfarë afati për zbatimin e një vendimi për lirimin e një të ndaluarit është i pranueshëm, e shpeshherë i pashmangshëm. Megjithatë, autoritetet kombëtare duhet të përpiqen që ta zvogëlojnë atë në minimum (Giulia Manzoni k. Italisë, par. 25). Është konstatuar që një vonesë prej njëmbëdhjetë orësh për zbatimin e një vendimi që urdhëronte lirimin “menjëherë” të një parashtruesi është i papajtueshëm me nenin 5 par. 1 të Konventës (po aty; Quinn k. Francës, par. 39-43).
32. Përsëri ritheksoj se qëllim kryesor i nenit 29 të Kushtetutës dhe nenit 5 të KEDNJ-së është parandalimi i mohimit arbitrar ose të pa justifikuar të lirisë së individit (shih rastet e GJEDNJ-së, [Selahattin Demirtas kundër Turqisë](#) (nr. 2), nr. 14305/17, Aktgjykim i 22 dhjetorit 2020, paragrafi 311; [S., V. and A. kundër Danimarkës](#), nr. 35553/12, 36678/12 dhe 36711/12, Aktgjykim i 22 tetorit 2018, paragrafi 73; [McKay kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 543/03, Aktgjykim i 3 tetorit 2006, paragrafi 30). E drejta për liri dhe siguri është e rëndësishme më të lartë në një “shoqëri demokratike” siç kuptohet nga Kushtetuta dhe KEDNJ-ja (shih rastet e GJEDNJ-së, [Medvedjev dhe tjerët kundër Francës](#), nr. 3394/03, Aktgjykim i 29 marsit 2010, paragrafi 76; [Ladent kundër Polonisë](#), nr. 11036/03, Aktgjykim i 18 marsit 2008, paragrafi 45).
33. Vërej se Gjykata Kushtetuese e Kroacisë lidhur me qëllimin e paraburgimit si masë më e rreptë ndaj të pandehurit kishte shpjeguar: *“Paraburgimi si masë ligjore që ia mohon individit të drejtën për liri personale gjatë periudhës para nxjerrjes së vendimit përfundimtar gjyqësor për fajësinë e tij nuk është ndëshkim dhe nuk guxon të shndërrohet në ndëshkim për të arrestuarin. Paraburgimi mund të urdhërohet vetëm në rastet ku ka gjasa të mëdha që individi është fajtor dhe se do t’i shqiptohet dënimi, pra që ekziston “dyshimi i arsyeshëm” që individi ka kryer krimin dhe, në parim, vetëm për t’u siguruar për fillimin dhe zbatimin e procedurës penale”* (shih Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë nr. [U-III-3698/2003](#) i 28 shtatorit 2004).
34. Po ashtu, vërej se Gjykata Kushtetuese e Kroacisë lidhur me parimin e proporcionalitetit në rastet e paraburgimit kishte shpjeguar: *“Parimi i proporcionalitetit është posaçërisht i rëndësishëm për t’i vendosur rastet e paraburgimit, dhe posaçërisht duke marrë parasysh bazat dhe arsyetimin për paraburgim të vazhduar pas kalimit të afateve të caktuara me ligj, sepse paraburgimi është masa më e rëndë ligjore për të siguruar praninë e të pandehurit (në rastin konkret, të të akuzuarit) gjatë procedurës penale. Vetëm paraburgimi ia mohon individit lirinë, në dallim nga masat e tjera që vetëm kufizojnë lirinë e tij”* (shih Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë nr. [U-III-3698/2003](#) cituar më lart).
35. Në këtë drejtim, vërej se dispozita e nenit 171 [Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit] të Ligjit të kontestuar përveç paraburgimit si masë më e rreptë për të siguruar praninë e të pandehurit dhe për zbatim të suksesshëm të procedurës penale parashikon edhe masa të tjera më të buta siç janë: (i) thirrja; (ii) urdhërarrestit; (iii) premtimi i të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin; (iv) ndalimi për t’iu afruar vendit ose

- personit të caktuar; (v) paraqitja në stacionin policor; (vi) dorëzania; dhe (vii) arresti shtëpiak.
36. Vlerësoj se me kalimin e kohës, zhvillimin dhe vërtetimin e hetimeve dhe marrjen e deklaratave, mbajtja e të pandehurit në paraburgim nuk mund të justifikohet por duhet vënë në përdorim masa tjera më të buta për ta siguruar praninë e tij në procedurë penale, të cilat masa janë të parashikuara me ligj dhe që janë në pajtim me garancitë themelore të nenit 29 të Kushtetutës dhe nenit 5 të KEDNJ-së. (shih mutatis mutandis rastin e GJEDNJ-së, [Clooth kundër Belgjikës](#), Aktgjykim i 12 dhjetorit 1991, paragrafi 44).
37. Verësoj se shikuar objektivisht nëse ndaj të pandehurit caktohet një masë më e butë sesa paraburgimi pas shqyrtimit nga gjykata e faktit dhe gjykata me jurisdikcion apeli, atëherë, kjo lë të kuptohet se ato gjykata kanë grumbulluar dhe vlerësuar të gjitha provat, kanë pranuar deklaratat, kanë vlerësuar se për shkak të kalimit të kohës rreziku që i pandehuri të pengojë zhvillimin e drejtë të procedurës penale është i zvogëluar dhe se prania e të njëjtit në procedurë penale mund të sigurohet me një masë më të butë e cila ka karakter kufizues për dallim nga paraburgimi që është masë më e rreptë që e mohon lirinë e individit (shih Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë [U-III-3698/2003](#) cituar më lart). Në kontekst të dispozitave përkatëse të Ligjit të kontestuar, vlerësoj se dhënia e mundësisë Prokurorit të Shtetit që të kontestojë vendimin e formës së prerë për ndërprerje të paraburgimit të të pandehurit përkeqëson pozitën e të pandehurit në procedurë penale sepse bie ndesh me parimin e parashikueshmërisë dhe ndalimit të veprimit retroaktiv të instrumenteve ligjore. (CDL-AD(2014)021 Opinion i Komisionit të Venedikut mbi draft-ligjin për amendamentet dhe shtesat në kodin gjyqësor të Armenisë, paragrafi 19).
38. Po ashtu konsideroj se ndryshimi i vendimit për ndërprerje të paraburgimit në dëm të të pandehurit me mjet të jashtëzakonshëm juridik-kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë nga Prokurori i Shtetit është e papranueshme në një shoqëri demokratike të karakterizuar me sundim të ligjit sepse: **(i)** në kuptimin subjektiv përkeqëson pozitën e të pandehurit në procedurë penale; ndërsa, **(ii)** në kuptimin objektiv: **a)** nëpërkëmbet liria dhe siguria e individit çka konsiderohet e drejtë e rëndësishme më të lartë në një “shoqëri demokratike” (shih rastet e GJEDNJ-së, [Medvedyev dhe tjerët kundër Francës](#), cituar më lart, paragrafi 76; [Ladent kundër Polonisë](#), cituar më lart, paragrafi 45); dhe, **b)** bie ndesh me qëllimin kryesor të nenit 29 të Kushtetutës dhe nenit 5 të KEDNJ-së për parandalimin e mohimit arbitrar ose të pa justifikuar të lirisë së individit (shih rastet e GJEDNJ-së [Selahattin Demirtaş kundër Turqisë](#) (nr. 2), cituar më lart, paragrafi 311; [S., V. and A. kundër Danimarkës](#), cituar më lart, paragrafi 73; [McKay kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), cituar më lart, paragrafi 30).
39. Në këtë kontekst, vlerësoj se bazuar në parimin e barazisë së armëve në procedurë penale, Prokurorit të Shtetit duhet t’i jepet mundësia që të paraqesë mjetin e jashtëzakonshëm kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe që më pas-nëse kërkesa është e bazuar- Gjykata referuese si autoriteti më i lartë gjyqësor (shih neni 103.2 i Kushtetutës) të kufizohet vetëm në konstatimin se ka pasur shkelje të ligjit, por ky vendim mund të jetë i natyrës deklarative dhe Gjykata Supreme vendimin e gjykatës së instancës më të ulët nuk mund ta ndryshojë në dëm të të pandehurit.
40. Nga sa më sipër, konstatoj se formulimi “ose ndërprerjen” i paragrafit 4 të nenit 432 (Arsyet për paraqitje së kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë) të Kodit nr. 08/L-032 të Procedurës Penale, nuk është në kundërshtim me nenin 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës në lidhje me nenin 5 (E drejta për liri dhe siguri) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

D) Konteksti i rasteve të bashkuara KO192/23 dhe KO229/23 ku zbatohet parimi “ne bis in idem”

41. Në anën tjetër, kërkesat e bashkuara KO192/23 dhe KO229/23 i referohen kundërshtimit të provave dhe hedhjes së aktakuzës, përkatësisht vendimit të formës së prerë përmes të cilit përfundohet procedura penale. Rrjedhimisht, theksoj se kërkesat e bashkuara KO192/23 dhe KO229/23 do të vlerësohen në kontekst të parimit *ne bis in idem* të garantuar me nenin 34 [E drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër] të Kushtetutës në lidhje me nenin 4 (2) (E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë) të Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së.
42. Rikujtoj se Gjykata referuese në rastin KO193/23 thekson se gjyqtarët e degës penale të Gjykatës Supreme të Kosovës pas takimit kanë vlerësuar se në këtë rast është e nevojshme të fillohet procedura e kontrollit incidental meqenëse nuk janë të sigurt “*nëse dispozita ligjore nga neni 438, paragrafi 2 i KPP-së (që i referohet kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur në dëm të të pandehurit), është në përputhje me dispozitat e Kushtetutës së Republikës të Kosovës dhe me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ndërsa një interpretim i tillë është i rëndësishëm për të vendosur për këtë çështje penale*”.
43. Më tej, Gjykata referuese vlerëson se Gjykata Kushtetuese duhet të sqarojë tri (3) gjëra të rëndësishme, përkatësisht: (i) së pari, çfarë nënkuptohet me termin e përdorur nga legjislativi “*qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë*”, pasi kjo mund të shkaktojë paqartësi në interpretim; (ii) së dyti, si duhet të veprojnë gjykata pasi ka konstatuar se bëhet fjalë për një “*vendim qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë*”, pasi kjo nuk sqarohet nga kjo dispozitë ligjore; dhe, (iii) së treti, kjo mënyrë e vendosjes në dëm të të pandehurit, sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë së Kryeprokurorit të Shtetit, me mjet të jashtëzakonshëm juridik, a është në përputhje me parimet dhe dispozitat kushtetuese, si dhe me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
44. Në fund, Gjykata referuese në kërkesën KO229/23 thekson se “*në rastin konkret ndaj aktvendimit të formës së prerë, përveç mbrojtësve të të pandehurve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kishte ushtruar edhe prokurori i shtetit, duke pasur parasysh se në kërkesë propozoi që për shkak të “gabimeve të rënda” lënda të kthehet në rivendosje, pyetja që parashtrohet është se a mund të ndryshohet vendimi i formës së prerë me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si mjet i jashtëzakonshëm juridik në dëm të të pandehurve dhe a janë dispozitat e nenit 4 par.2 dhe nenit 438 par. 2 të KPP-së në përputhshmëri me nenet 30, 31, 34 dhe 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës*”.
45. Në këtë kontekst, nga rastet e bashkuara KO192/23 dhe KO229/23 ku zbatohet parimi “*ne bis in idem*”, vlerësoj se objekt i vlerësimit kushtetues janë paragrafi 2 i nenit 4 (Ne Bis In Idem) i ligjit të kontestuar i cili përcakton: (i) 2. *Me përjashtim të rasteve kur me këtë Kod është paraparë ndryshe, vendimi gjyqësor i formës së prerë mund të ndryshohet me mjete të jashtëzakonshme juridike; dhe (ii) paragrafi 2 i nenit 438 (Aktgjykimi mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë) që përcakton: 2. Kur Gjykata Supreme e Kosovës çmon se kërkesa e paraqitur për mbrojtjen e ligjshmërisë në dëm të të pandehurit është e bazuar, vetëm konstaton shkeljen e ligjit pa ndikuar në vendimin e formës së prerë, përveç nëse vendimi i formës së prerë është qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë, përkatësisht nëse këto të fundit janë në pajtim me nenin 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 4 (2) të Protokollit nr. 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).*
46. Për shkak të sa më sipër, fillimisht do të paraqes parimet e përgjithshme që lidhen me institutin e drejtësisë *Ne bis in idem* bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, dhe më pas do t'i zbatojë këto parime në rastet konkrete në kontekstin e ligjit të kontestuar dhe rasteve të bashkuara KO192/23 dhe KO229/23, dhe të bëjë vlerësimin e kushtetutshmërisë

së par. 2 të nenit 4 (Ne Bis In Idem) dhe paragrafi 2 i nenit 438 (Aktgjykimi mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë).

E) Parimet e përgjithshme në lidhje institutin e drejtësisë Ne bis in idem bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së

47. Protokollit nr. 7 i Konventës është hartuar më 1984. Qëllimi i nenit 4 të Protokollit nr. 7 është ndalimi i përsëritjes së procedurave penale të mbyllura me vendim të formës së prerë (*ne bis in idem*).
48. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës, garancia e parashikuar në nenin 4 të Protokollit nr. 7 zë një vend të spikatur në sistemin e mbrojtjes të Konventës, siç nënvizohet nga fakti se asnjë derogim nga ajo nuk lejohet sipas nenit 15 të Konventës në rast lufte ose rreziku tjetër publik (*Mihalache kundër Rumanisë* [DHM], 2019, par. 47).
49. Mbrojtja kundër përsëritjes së procedurave penale është një nga masat mbrojtëse specifike që ndërlihen me garancinë e përgjithshme për një seancë dëgjimore në procedurë penale (*ibid*, par. 48). Sidoqoftë, meqenëse neni 4 i Protokollit nr. 7 është i ndarë nga neni 6 i Konventës, ankesat sipas të parit do të deklarohen të papranueshme nëse Shteti në fjalë nuk e ka ratifikuar protokollin (*Blokker kundër Holandës* (vend.), 2000).
50. Neni 4 i Protokollit nr. 7 të Konventës ruan një të drejtë themelore e cila garanton se askush nuk duhet të gjykohet ose ndëshkohet në procedurë penale për një vepër për të cilën ai ose ajo tashmë është dënuar ose shpallur i pafajshëm (*Marguš kundër Kroacisë* [DHM], 2014, par. 114; *Sergey Zolotukhin kundër Rusisë* [DHM], 2009, par. 58; *Nikitin kundër Rusisë*, 2004, par. 35; dhe *Kadusic kundër Zvicrës*, 2018, par. 82). Aspekti i përsëritjes të gjyqimit ose dënimit është thelbësor për problemin juridik të adresuar nga neni 4 i Protokollit Nr. 7 (*Nikitin kundër Rusisë*, 2004, par. 35).

Struktura e nenit

Neni 4 i Protokollit nr. 7 - E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë

“1. Askush nuk mund të ndiqet ose të dënohet penalisht nga gjykatat e të njëjtit shtet për një vepër për të cilën ai më parë është shpallur i pafajshëm ose dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë, në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të atij Shteti.

2. Dispozitat e paragrafit të mësipërm nuk e pengojnë rihapjen e procesit, në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të shtetit të interesuar, në rast se ka fakte të reja ose të zbuluara rishtazi, apo ka një mangësi themelore në procedurën e mëparshme që janë të një natyre të tillë që mund ta cenojnë vendimin e dhënë.

3. Asnjë derogim nuk lejohet për këtë nen në përputhje me nenin 15 të Konventës.”

51. Neni 4 përmban tre paragrafë. Paragrafi i parë parashtron tre elemente përbërëse kyç të parimit *ne bis in idem* (*Mihalache kundër Rumanisë* [DhM], 2019, par. 49):
 - a. a kanë qenë të dy procedurat me natyrë “penale”,
 - b. a kishin të bëjnë të dy procedurat për të njëjtën vepër, dhe
 - c. A ka ardhur deri te dyfishimi i procedurës.

Elementi i tretë përbërës përfshin tri nën-pyetje të veçanta:

- i. a ka pasur procedura të reja

- ii. nëse po, a është përfunduar grupi i parë i procedurave me një vendim të formës së prerë; dhe
- iii. a është i aplikueshëm përjashtimi i cekur në paragrafin e dytë.

I. A ka ekzistuar grupi i ri i procedurave

52. Neni 4 të Protokollit nr. 7 e ndalon përsëritjen e procedurës penale të përfunduar me vendim të formës së prerë. Neni 4 të Protokollit nr. 7 nuk është i kufizuar vetëm në të drejtën për të mos u dënuar dy herë, por edhe të drejtën për të mos u ndjekur ose gjykuar dy herë. Ai zbatohet edhe atëherë kur ndjekja nuk ka përfunduar me një dënim (*Sergueï Zolotoukhin kundër Ruisë* [DHM], 2009, par. 110-111, lidhur me një shpallje pafajësie në përfundim të grupit të dytë të procedurave).
53. Gjykata konstatoi se neni 4 i Protokollit nr. 7 e ndalon qartësisht nisjen e një procedimi të ri në qoftë e i pari është përfunduar me një vendim të formës së prerë (*Sergueï Zolotoukhine k. Ruisë*, 2009).
54. Megjithatë, neni 4 i Protokollit nr. 7 nuk e ndalon që të kryhen paralelisht disa procedime të njëkohshme (litis pendens). Në një rast të tillë, nuk mund të pretendohet që i pandehuri të jetë ndjekur disa herë “për arsye të një veprë për të cilën ai tashmë është shpallur i pafajshëm apo dënuar me një vendim të formës së prerë” (Garaudy k. Francës (vend. pran.)). Gjithashtu, nga pikëpamja e Konventës nuk është ndonjë gjë problematike që, në rastin e dy procedimeve të njëkohshme, nga i dyti të hiqet dorë pasi ka marrë formë të prerë vendimi që e mbyll të parin (Zigarella k. Italisë (vend. pran.)). Mirëpo, në qoftë se nuk hiqet dorë nga procedimi i dytë, Gjykata del në përfundimin se ka pasur përsëritje të ndjekjes e, për këtë arsye, shkelje të nenit 4 të Protokollit nr. 7 (Tomasović k. Kroacisë, §§ 29-32, Muslija k. Bosnjë-Hercegovinës, §§ 36-37, Nykänen k. Finlandës, §§ 47-54, Glantz k. Finlandës, §§ 57-64).
55. Megjithatë, Gjykata, në praktikën e saj gjyqësore gjithashtu ka konstatuar në lidhje me çështjet që kanë pasur të bëjnë me heqjen e lejes së drejtimit, ka gjykuar gjithashtu se, ndonëse ishin dhënë sanksione të ndryshme (sanksione penale dhe heqje leje drejtimi) lidhur me të njëjtat fakte (drejtim automjeti në gjendje të dehur ose tejkalim i kufirit të shpejtësisë së lejuar) nga ana e autoriteteve të ndryshme në kuadrin e disa procedimeve të ndryshme, midis tyre kishte një lidhje mjaft të ngushtë, nga pikëpamja materiale dhe kohore, në mënyrë që ato të konsideroheshin se bënin pjesë në të njëjtin procedim (Nilsson k. Suedisë (vend. pran.) dhe Maszni k. Rumanisë, §§ 68-70). Në këto çështje, ajo ka dalë në konkluzionin se të pandehurit nuk ishin gjykuar as dënuar për herë të dytë për arsye të një veprë për të cilën ata kishin qenë tashmë objekt i një dënimi të formës së prerë dhe se nuk kishte kështu përsëritje procedimi në kundërshtim me nenin 4 § 1 të Protokollit nr. 7 të Konventës. Për shembull, në çështjen Boman k. Finlandës, i pandehuri ishte dënuar, për një veprë qarkullimi rrugor, me një pezullim të lejes së drejtimit. Pas kësaj, prefektura dhe juridiksionet administrative e kishin zgatur këtë pezullim në kuadrin e një procedimi më vete. Gjykata ka shënuar se vendosja e pezullimit të dytë presupozonte që i pandehuri të ishte gjykuar tashmë fajtor për veprën e qarkullimit rrugor. Ajo ka qenë gjithashtu e mendimit se vendimi për ta zgatur pezullimin e lejes, i marrë pak pas vendimit të dhënë në procedimin penal, mbështetej drejtpërdrejt te dënimi i formës së prerë të pandehurit nga Gjykata e Rrethit për veprën e qarkullimit rrugor dhe nuk përmbante kështu një shqyrtim më vete nga ana e policia as për veprën, as për sjelljen në fjalë. Ajo ka dalë pra në konkluzionin se të dy procedimet ishin të lidhura thelbësisht midis tyre, nga pikëpamja materiale dhe kohore, dhe se ato përbënin kështu të njëjtin procedim të vetëm në vështrim të nenit 4 të Protokollit nr. 7 të Konventës (shih gjithashtu Rivard k. Zvicrës, §§ 28-34).
56. Gjykata ka shqyrtuar rastin e sanksioneve tatimore në disa çështje lidhur me Finlandën e me Suedinë (Häkka k. Finlandës, Nykänen k. Finlandës, Glantz k. Finlandës, Rinas k.

Finlandës, Österlund k. Finlandës, Kiiveri k. Finlandës dhe Lucky Dev k. Suedisë). Në këto çështje, ajo ka shënuar se, në sistemin finlandez e atë suedez, sanksionet penale dhe administrative vendoseshin nga autoritete të ndryshme pa pasur kurrfarë lidhjeje midis procedimeve: në secilin rast, edhe njëri procedim, edhe tjetri ishin ndjekur veçmas e në mënyrë të pavarur deri në përfundimin e tyre me vendim të formës së prerë. Për më tepër, sanksionet e vendosura në kuadrin e njërit procedim nuk ishin marrë parasysh nga instanca që kishte marrë vendim në kuadrin e procedimit tjetër kur ajo kishte përcaktuar seriozitetin e sanksionit, dhe nuk kishte asnjë ndërveprim ndërmjet autoriteteve kompetente. Përveç kësaj, Gjykata ka vërejtur se rritjet e tatimeve ishin vendosur pas një shqyrtimi të sjelljes së paditësit dhe të përgjegjësisë së tij në vështrim të së drejtës tatimore, të bërë pavarësisht nga vlerësimi i realizuar në kuadrin e procedimit penal. Ajo ka qenë e mendimit se kjo situatë ishte e ndryshme nga ajo e çështjeve lidhur me pezullime lejesh drejtimi që asaj i ishte dashur të shqyrtonte më parë, ku vendimi për pezullim të lejes mbështetej drejtpërdrejt te një dënim i parashikuar ose i formës së prerë për një vepër qarkullimi rrugor dhe nuk përmbante kështu ndonjë shqyrtim më vete të veprës ose të sjelljes në fjalë. Për rrjedhojë, ajo ka dalë në konkluzionin se nuk kishte ndonjë lidhje të ngushtë, nga pikëpamja materiale dhe kohore, ndërmjet procedimit penal dhe procedimit tatimor.

57. Atëherë lind pyetja nëse ka pasur dyfishim të procedurës (bis). Në çështjen A e B k. Norvegjisë [DhM], Gjykata ka shqyrtuar sistemin norvegjez të procedurës së dyfishtë penale dhe administrative në rast deklarimesh tatimore jokorrekte. Ajo ka shtjelluar parimin e sipërpërmendur të “lidhjes materiale dhe kohore mjaft të ngushtë” ndërmjet procedurave dhe ka thënë se mënyra më e sigurt për t’u kujdesur për respektimin e neni 4 të Protokollit nr. 7 është që të parashikohet një procedurë me vetëm një nivel, e cila mundëson bashkimin e degëve paralele të regjimit juridik që udhëheq veprimtarinë në fjalë, në mënyrë që të përmbushen në kuadrin e një procesi të vetëm nevojat e ndryshme që ndjek shoqëria në kundërpërgjigjen e saj përballë kryerjes së një vepre, por se neni 4 i Protokollit nr. 7 nuk e përjashtonte ndjekjen e procedurave të dyfishta, madje deri në fund të tyre, mjafton që të plotësohen disa kushte. Kështu, shteti i paditur duhet të vërtetojë në mënyrë bindëse se procedurat e dyfishta në fjalë kanë qenë të bashkuara nga një “lidhje materiale dhe kohore mjaft e ngushtë” (§ 130). Elementet me rëndësi që duhet të merren parasysh për të vendosur nëse ekziston ose jo një lidhje materiale dhe kohore “mjaft e ngushtë” janë konkretisht si më poshtë (§ 132):

- a) pika nëse procedurat e ndryshme synojnë qëllime bashkëplotësuese dhe kanë të bëjnë kështu, jo vetëm in abstracto por edhe in concreto, me aspekte të ndryshme të aktit të dëmshëm ndaj shoqërisë për të cilin është fjala;
- b) pika nëse dyfishësia e procedurave në fjalë është një pasojë e parashikueshme, si ligjërisht ashtu edhe praktikisht, e së njëjtës sjellje të ndëshkuar (*idem*);
- c) pika nëse procedurat në fjalë janë ndjekur në një mënyrë që e shmang sa të jetë e mundur çdo përsëritje në grumbullimin e në vlerësimin e provave, sidomos në saje të një ndërveprimit të përshtatshëm ndërmjet autoriteteve të ndryshme kompetente, në të cilin shihet qartë se përcaktimi i fakteve i bërë në njërin nga procedurat është marrë te tjetra;
- d) e sidomos, pika nëse sanksioni i vendosur në përfundim të procedurës që mbaron e para është marrë parasysh në procedurën që mbaron e fundit, në mënyrë që i interesuari të mos ngarkohet më në fund me një barrë të tepruar, meqenëse ky rrezik i fundit ka më pak gjasa të paraqitet po qe se ekziston një mekanizëm rregullues i konceptuar për të siguruar që shuma e përgjithshme e të gjitha dënimeve të dhëna të jetë e përpjesëtuara.

58. Përveç kësaj, Gjykata ka theksuar se masa në të cilën procedura administrative paraqet karakteristikat e një procedure të zakonshme penale, sidomos karakteristikat e saj turpëruese, është një element i rëndësishëm. Gjykata shpjegoi se procedimet e kombinuara ka më shumë gjasa të përmbushin kriteret e plotësueshmërisë dhe koherencës nëse sanksionet që do të vendosen në procedime që nuk klasifikohen zyrtarisht si “penale” janë specifike për sjelljen në fjalë dhe kështu ndryshojnë nga “bërthama e ligjit penal” (§ 133;

- shih, për shembull, çështjen *Velkov kundër Bullgarisë*, 2020 ku kriteret A dhe B u zbatuan në kontekstin e huliganizmit sportiv) shih gjithashtu *Goulandris dhe Vardinogianni kundër Greqisë*, 2022, § 74, ku Gjykata, për qëllimin e kriterit të "lidhjes në thelb", shqyrtoi aspektin e "thelbit të së drejtës penale" në kontekstin e vlerësimit nëse dy grupet e procedimeve (administrative dhe penale) për ndërtime të paligjshme ndoqën qëllime plotësuese).
59. Për më tepër, edhe në qoftë se lidhja *materiale* është mjaft e fuqishme, kushti i lidhjes *kohore* prapëseparapë mbetet dhe duhet të përmbushet. Ajo ka saktësuar se, megjithatë, të dyja procedurat nuk duhet të ndiqen njëkohësisht nga fillimi deri në fund, sepse Shteti duhet të ketë aftësinë për të zgjedhur ndjekjen e procedurave në mënyrë progresive në qoftë se kjo mënyrë veprimi përlligjet me një motiv efektshmërie dhe miradministrimi të drejtësisë, ndjek qëllime të ndryshme shoqërore dhe nuk i shkakton ndonjë dëm të shpërpjesëtuar parashtruesit të kërkesës. Sidoqoftë, duhet të ketë përherë një lidhje *kohore* mjaft të ngushtë, në mënyrë që individit të mos i nënshtrohet pasigurisë e zvarritjeve dhe që procedurat të mos shtrihen tepër gjatë në kohë, edhe në qoftë se regjimi kombëtar përkatës parashikon një mekanizëm "të integruar" që përmban një komponent administrativ dhe një komponent penal të ndarë nga njëri-tjetri (§ 134).
60. Duke i zbatuar këto parime te faktet e çështjes në fjalë, Gjykata ka çmuar se vërtetohej që, ndonëse parashtruesve të kërkesës u ishin vënë sanksione të ndryshme nga dy autoritete të ndryshme dhe gjatë procedurave të ndryshme, midis këtyre të fundit ekzistonte megjithatë një lidhje mjaft e ngushtë, si materiale ashtu edhe kohore, "për t'i konsideruar ato se përfshiheshin në mekanizmin e integruar të sanksioneve të parashikuara nga e drejta norvegjeze" në rast mos-deklarimi të dhënash për disa të ardhura në një deklaratë tatimore. Ajo ka gjykuar kështu që procedura e dyfishtë nuk përbënte një përsëritje ndjekjeje që ndalohet nga neni 4 i Protokollit nr. 7 të Konventës (§§ 144-147 dhe §§ 149-154).
61. Përkundrazi, në çështjen *Johannesson dhe të tjerët kundër Islandës*, 2017, Gjykata gjeti se edhe nëse të dy procedimet ndiqnin qëllime plotësuese në adresimin e çështjes së mos paraqitjes së deklaratave tatimore nga ana e taksapaguesve në përputhje me kërkesat ligjore (§ 51), nuk kishte asnjë lidhje të ngushtë sa duhet, për shkak të ndërthurjes së kufizuar në kohë dhe mbledhjes dhe vlerësimit kryesisht të pavarur të provave (§ 55). Si pasojë, parashtruesit e kërkesës iu nënshtroan një paragjykim jo-proporcional si rezultat i gjykimit dhe dënimit për të njëjtën sjellje ose thelbësisht të njëjtë nga ana e autoriteteve të ndryshme në dy procedura të ndryshme të cilave u mungonte lidhja e kërkuar.
62. Në mënyrë të ngjashme, në çështjen *Nodet kundër Francës*, 2019, § 53, në lidhje me dy grupe procedurash paralele (administrative dhe penale) për manipulimin e tregut, Gjykata mori parasysh faktin se këto dy grupe procedurash ndiqnin të njëjtin qëllim dhe përfshinin, deri në një farë mase, grumbullimin e pavarur të provave, gjë që e çoi atë në përfundimin se nuk kishte një lidhje mjaftueshëm të ngushtë në thelb midis tyre. Për më tepër, Gjykata konstatoi se nuk kishte lidhje të mjaftueshme në kohë ndërmjet dy grupeve të procedurave. Rrjedhimisht, Gjykata arriti në përfundimin se parashtruesi i kërkesës pësoi paragjykim joproporcional për shkak se ishte gjykuar dhe dënuar dy herë për të njëjtën vepër.
63. Në çështjen *Mihalache kundër Rumanisë* [DHM], 2019, § 84, Gjykata gjeti që të dy grupet e procedimeve - njëra para prokurorit dhe tjetra para gjykatës përkatëse - nuk ishin të kombinuara në një mënyrë të integruar, për të formuar një tërësi koherente. Gjykata kishte parasysh faktet e mëposhtme: parashtruesi i kërkesës u ndoq penalisht në "të dyja" procedurat për një vepër të vetme të dënueshme me një dispozitë të vetme ligjore; procedimet dhe dy dënimet e shqiptuara ndaj ankuesit ndoqën të njëjtin qëllim të përgjithshëm; grupi i "i parë" i procedimeve në tërësi dhe pjesa fillestare e grupit të "dytë" është zhvilluar nga i njëjti autoritet; dhe "të dyja" grupet e procedimeve prodhuan të

njëjtat prova; dy dënimet e shqiptuara ndaj parashtruesit të kërkesës nuk ishin të kombinuara; dhe “të dy” grupet e procedimeve u zhvilluan njëra pas tjetrës dhe nuk u zhvilluan njëkohësisht në çfarëdo kohë.

64. Pas arritjes në konkluzionin se të dy grupet e procedimeve nuk ishin të integruara në mënyrë të tillë që të formonin një tërësi koherente, Gjykata vlerësoi që për të përcaktuar nëse, në çështjen në fjalë, kishte dyfishim të procedimeve (“bis”) në vështrim të Nenit 4 të Protokollit Nr. 7, kërkohej të shqyrtohej nëse vendimi në grupin e parë të procedimeve përbënte një vendim “prerë” që e “shpallte të pafajshëm apo e dënonte” parashtruesin e kërkesës. Ajo theksoi që, në mënyrë pozitive, atëherë duhet të përcaktohet nëse një vendim për të anuluar atë “vendim të prerë” përbënte një rihapje të çështjes në përputhje me nenin 4 të Protokollit Nr. 7 (*ibid.*, §§ 85-86).
65. Në çështjen *Velkov kundër Bullgarisë*, 2020, §§ 78-79, Gjykata konstatoi, ndër të tjera, se nuk kishte lidhje të mjaftueshme në thelb midis procedimit administrativ dhe atij penal për huliganizëm sportiv për arsye se sanksioni i vendosur në procedim administrativ nuk ishte marrë parasysh me rastin e caktimit të sanksionit të shqiptuar në procedim penal. Në të kundërt, në *Bajçiq kundër Kroacisë*, 2020, § 44, ku në kontekstin e dënimit penal të parashtruesit të kërkesës për shkaktimin e një aksidenti rrugor fatal, gjykata penale nuk mori parasysh sanksionin e vendosur në procedurën e kundërvajtjes, Gjykata vlerësoi se Fakti i vetëm që gjykata penale nuk i referoi *expressis verbis* sanksionit të vendosur në procedurën e kundërvajtjes, në vetvete nuk mund të mjaftonte për të arritur në përfundimin se procedurat nuk ishin të ndërlidhura në thelb. Në lidhje me këtë, Gjykata vuri theksin në faktin se, të marra së bashku, dënimet e vendosura nuk e kalonin atë që ishte rreptësisht e nevojshme në lidhje me seriozitetin e veprave në fjalë. Gjykata i konsideroi dy sanksionet si plotësuese dhe kështu arriti në përfundimin se parashtruesi i kërkesës nuk mbante një barrë të tepërt.
66. Në çështjen *Galović kundër Kroacisë*, 2021, §§ 113-124, Gjykata zbatoi, për herë të parë, parimet e vendosura në *A dhe B kundër Norvegjisë*, 2016, në lidhje me zhvillimin e procedurave të dyfishta, në kontekstin e veçantë të dhunë në familje. Ajo mori parasysh kontekstin dhe dinamikën specifike të dhunës në familje kur konsideroi se dy procedimet në fjalë (procedurat për kundërvajtje sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje në lidhje me dy incidente të veçanta dhe procedimet penale sipas Kodit Penal për veprën e vazhdueshme të dhuna në familje) ishin mjaft të lidhura ngushtë në thelb dhe në kohë. Prandaj, ai konstatoi se dy procedimet në fjalë formonin një tërësi koherente dhe proporcionale, e cila mundësoi që aktet individuale të kryera nga parashtruesi i kërkesës dhe modeli i tij i sjelljes të dënoheshin në një mënyrë efektive, proporcionale dhe bindëse, duke mos arritur që të përbëj, për rrjedhojë, një dyfishim të dënimit në kundërshtim me nenin 4 të protokollit nr. 7.

II. A ka pasur vendim të formës së prerë

67. Neni 4 i Protokollit Nr. 7 thotë se parimi *ne bis in idem* ka për objekt të mbrojtje personat që tashmë janë “shpallur të pafajshëm ose dënuar me vendim të prerë”. Raporti shpjegues rreth Protokollit Nr. 7 thekson, në lidhje me Nenin 4, se “parimi i vendosur në këtë dispozitë zbatohet vetëm pasi që personi të jetë liruar ose dënuar përfundimisht në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të Shtetit në fjalë”. Në mënyrë që një person të kualifikohet për mbrojtje sipas këtij neni, një vendim i prerë nuk është i mjaftueshëm; vendimi i prerë duhet të përfshijë gjithashtu shpalljen e pafajësisë apo dënimin e personit. Andaj, në secilin rast, Gjykata duhet të përcaktojë nëse kishte një shpallje pafajësie apo dënim. Nëse është kështu, ajo duhet të përcaktojë nëse një vendim ishte i “prerë” për qëllimet e Nenit 4 të Protokollit Nr. 7 (*Mihalache kundër Rumanisë* [DHM], 2019., §§ 88-89).

Ekzistenca e një “aktgjykimi lirues apo dënues”

68. Siç shpjegohet në çështjen *Mihalache kundër Rumanisë* [DhM], 2019, §§ 95 dhe 97, në mënyrë që të përcaktojë nëse një vendim i veçantë përbën një “shpallje pafajësie” ose “dënim”, Gjykata duhet të marrë në konsideratë përmbajtjen aktuale të vendimit në fjalë dhe të vlerësoj efektet e tij në situatën e parashtruesit të kërkesës. Në këtë kontekst, ndërhyrja gjyqësore është e panevojshme për ekzistencën e një “vendimi” dhe vendimi në fjalë nuk ka pse të marrë formën e një aktgjykimi (shih *Felix Guțu kundër Republikës së Moldavisë*, 2020, §§ 47-54, për zbatimin e kësaj praktike gjyqësore në kontekstin e nenit 6 § 2).
69. Duke iu referuar tekstit të Nenit 4 të Protokollit Nr. 7, Gjykata konsideroi se zgjedhja e qëllimshme e fjalëve “i shpallur i pafajshëm ose i dënuar” nënkuptonte që përgjegjësia “penale” e të akuzuarit ishte vendosur pas vlerësimit të rrethanave të çështjes, me fjalë të tjera se ka pasur një përcaktim për meritat e çështjes. Në mënyrë që të bëhet një vlerësim i tillë, është e rëndësishme jetike që autoriteti që nxjerrë vendimin të posedoj fuqinë vendimmarrëse që i jepet nga ligji i brendshëm që i mundëson atij të shqyrtojë meritat e një çështjeje. Autoriteti atëherë duhet të studiojë ose vlerësojë provat në shkresat e çështjes dhe të vlerësojë përfshirjen e parashtruesit të kërkesës në një ose të gjitha ngjarjet që nxisin ndërhyrjen e organeve hetimore, për qëllimet e përcaktimit nëse është vërtetuar përgjegjësia “penale” (*Mihalache kundër Rumanisë* [DHM], 2019, § 97).
70. Kësisoj, konstatimi se ka pasur një vlerësim të rrethanave të çështjes dhe të fajësisë ose të pafajësisë së të akuzuarit mund të mbështetet nga progresi i procedurave në një çështje të caktuar. Kur një hetim penal ka filluar pasi një akuzë është ngritur kundër personit në fjalë, viktimi është intervistuar, provat janë mbledhur dhe shqyrtuar nga autoriteti kompetent, dhe një vendim i arsyetuar është nxjerrë në bazë të atyre provave, faktorët e tillë ka të ngjarë të çojnë në një konstatim se ka pasur një përcaktim lidhur me meritat e çështjes. Kur një ndëshkim është urdhëruar nga autoriteti kompetent si rezultat i sjelljes që i atribuohet personit në fjalë, mund të konsiderohet në mënyrë të arsyeshme se autoriteti kompetent kishte kryer një vlerësim paraprak të rrethanave të çështjes dhe nëse sjellja e personi në fjalë ishte i ligjshme (*ibid.*, § 98).
71. Në çështjen *Mihalache* (§§ 99-101), Gjykata iu referua faktit se sipas të drejtës së brendshme zyra e prokurorit publik u thirr për të marrë pjesë në administrimin e drejtësisë penale. Prokurori kishte juridiksionin për të hetuar veprimet e pretenduara të parashtruesit të kërkesës, duke marrë në pyetje një dëshmitar dhe të dyshuarin për këtë qëllim. Më pastaj, ai i zbatoi rregullat përkatëse materiale të përcaktuara në ligjin vendor; ai duhej të vlerësonte nëse ishin përmbushur kërkesat për cilësimin e veprimeve të pretenduara të parashtruesit të kërkesës si një vepër penale. Në bazë të provave të nxjerra, prokurori bëri vlerësimin e tij për të gjitha rrethanat e çështjes, në lidhje me parashtruesin e kërkesës individualisht dhe me gjendjen faktike specifike. Pas kryerjes së këtij vlerësimi, duke vepruar përsëri në përputhje me kompetencat e dhëna atij sipas drejtës së brendshme, prokurori vendosi të ndërpresë ndjekjen penale, ndërsa shqiptoi një dënim ndaj parashtruesit të kërkesës që kishte një qëllim ndëshkues dhe parandalues. Dënimi i vënë u bë i zbatueshëm me mbarimin e afatit kohor për ankesë nga ana e parashtruesit të kërkesës sipas drejtës së brendshme. Në këto rrethana, Gjykata gjeti se, pavarësisht nga çdo përfshirje gjyqësore, vendimi i prokurorit arrinte masën e një “dënimi” brenda kuptimit të Nenit 2 të Protokollit Nr. 7.
72. Në rastin *Smoković kundër Kroacisë* (vend.), 2019, §§ 43-45, Gjykata nuk konsideroi që një vendim që ndërpriste procedurën kundër parashtruesit të kërkesës në bazë të skadimit të afatit parashkrimit arrinte masën e një “dënimi” as “shpallje pafajësie” në vështrim të Nenit 4 të Protokollit Nr. 7 të Konventës. Në veçanti, ishte e qartë se ndërprerja e

procedurës nuk përbënte një “dënim”. Për sa i përket pyetjes nëse vendimi përbën një shpallje pafajësie, Gjykata kishte parasysh konsideratat e mëposhtme: vendimi nuk ishte bazuar në ndonjë hetim lidhur me akuzat e ngritura kundër parashtruesit të kërkesës; nuk ishte bazuar në ndonjë gjetje të fakteve të rëndësishme për përcaktimin e fajësisë ose pafajësisë së parashtruesit të kërkesës; nuk i kushtoi vëmendje fakteve, rrethanat ose provat në lidhje me veprimet e pretenduara, nuk i vlerësoi ato ose nuk vendosi për ta liruar atë; dhe nuk arrinte masën e një vlerësimit nëse parashtruesi i kërkesës mbante përgjegjësi për veprën e kundërshtuar, e cila normalisht do t'i paraprinte një shpalljeje pafajësie.

Vendimi i formës së “prerë”

73. Neni 4 i Protokollit nr. 7 ka për objekt që ta ndalojë përsëritjen e procedimeve penale (parimi *ne bis in idem*) të përfunduara me vendim të formës së prerë. Sipas raportit shpjegues rreth Protokollit nr. 7, raport që i referohet nga ana e tij Konventës Evropiane rreth Vlefshmërisë Ndërkombëtare të Vendimeve Penale, një vendim është i formës së prerë në qoftë se ai, sipas shprehjes së ngulitur tashmë, e ka marrë fuqinë e gjësë së gjykuar. I tillë është rasti kur ai është i përvokueshëm, domethënë kur kundër tij nuk ka më mundësi mjjetesh të zakonshme ligjore ose kur palët i kanë shteruar këto mjete apo i kanë lënë afatet të kalojnë pa i ushtruar ato (*Sergey Zolotoukhin kundër Rusisë* [DhM], 2009, § 107). Vendimet kundër të cilave ka mundësi mjjetesh të zakonshme ligjore nuk përfitojnë nga garancia që përmban neni 4 i Protokollit nr. 7 për atë kohë sa nuk ka përfunduar afati i apelimit (§ 108). Përkundrazi, mjjetet e jashtëzakonshme ligjore, si ndonjë kërkesë për rihapje të procedurës apo ndonjë kërkesë për zgjatje të një afati të përfunduar, nuk merren fare parasysh kur është fjala për të përcaktuar nëse procedura ka përfunduar me vendim të formës së prerë apo jo. Edhe pse këto mjete ligjore përfaqësojnë një vazhdim të procedurës së parë, karakteri “i formës së prerë” të vendimit nuk varet nga ushtrimi i tyre (§ 108).
74. Në rastin *Sundqvist kundër Finlandës* (vend.), 2005, Gjykata ka gjykuar, në dritën e së drejtës së brendshme të zbatueshme, se vendimi i një prokurori për të mos nisur ndjekje nuk duhej të konsiderohej si një vendim “i formës së prerë”. Për rrjedhojë, as fakti që Prokurori i Përgjithshëm kishte vendosur më vonë që të hapte një procedurë ndaj parashtruesit të kërkesës, e as dënimi i mëpasshëm nuk përbënin ndonjë procedim të ri që përfshihej në rrezen e veprimit të nenit 4 të Protokollit nr. 7. Gjykata ka thënë gjithashtu në çështje të ndryshme se heqja dorë nga ndjekja penale nga ana e një prokurorit nuk është e barasvlershme as me një dënim, as me një shpallje pafajësie dhe se, për rrjedhojë, neni 4 i Protokollit nr. 7 nuk gjen zbatim në këtë situatë (*Smirnova e Smirnova kundër Rusisë* (vend.), 2022 *Harutyunyan kundër Armenisë* (vend.), 2006, *Marguš kundër Kroacisë* [DhM], 2014, § 120; shih gjithashtu, rreth një shtrimi të përkohshëm me detyrim në një spital psikiatrik, të urdhëruar nga një prokuror, *Horciag kundër Rumanisë* (vend.) 2005). Kjo dispozitë nuk është e zbatueshme as në mbylljen e një procedimi penal të vendosur për arsye të amnistimit të akteve që përbëjnë shkelje të rënda të të drejtave themelore, si krime lufte kundër popullsisë civile (*Marguš kundër Kroacisë* [DhM], 2014, §§ 122-141). Në lidhje me këtë, Gjykata ka thënë se do të ishte në kundërshtim me detyrimet që i takojnë shtetit në bazë të neneve 2 dhe 3 të Konventës që të amnistohen veprat e vrasjes ose të keqtrajtimit të kryera ndaj civilëve, dhe ajo ka vënë në dukje ekzistencën e një prirjeje në rritje në të drejtën ndërkombëtare për ta konsideruar si të papranueshëm amnistimin e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut. Për rrjedhojë, ajo ka dalë në përfundimin se ngritja e një aktakuze të re ndaj një personi të amnistuar për akte të tilla nuk duhet të përfshihet në rrezen e veprimit të nenit 4 të Protokollit nr. 7.
75. Në çështjen *Mihalache kundër Rumanisë* [DhM], 2019, § 115, Gjykata sqaroi më tej metodologjinë e saj për vlerësimin e formës së prerë të një vendimi. Ajo shpjegoi se, në vendosjen e mjeteve juridike “të zakonshme” në një rast të veçantë për qëllimin e nenit 4

të Protokollit nr. 7, ajo merr ligjin dhe procedurën e brendshme si pikënisje. Ligji i brendshëm - si përmbajtësor ashtu edhe procedural - duhet të përmbushë parimin e sigurisë juridike, i cili kërkon që qëllimi i një mjeti juridik për qëllimet e nenit 4 të protokollit nr. 7 të kufizohet qartë në kohë dhe që procedura për përdorimin e tij të jetë e qartë për ato palë që lejohen të përdorin mjetin juridik në fjalë. Me fjalë të tjera, që të përmbushet parimi i sigurisë juridike, një parim që është i natyrshëm në të drejtën për t'u mos gjykuar ose dënuar dy herë për të njëjtën vepër, një mjet juridik duhet të funksionojë në një mënyrë që të sjellë qartësi deri në momentin kur një vendimi merr formë të prerë. Në veçanti, kërkesa e një afati kohor në mënyrë që një mjet juridik të konsiderohet si "i zakonshëm" është i nënkuptuar në formulimin e vetë raportit shpjegues, i cili thotë se një vendim është i parevokueshëm kur palët kanë lejuar "afatin kohor" të skadojë pa përfutur nga një mjet i tillë. Një ligj që i jep një diskrecion të pakufizuar njëres nga palët për të përdorur një mjet të veçantë juridik ose duke i nënshtuar një mjet të tillë kushteve që zbulojnë një çekuilibër të madh ndërmjet palëve në aftësinë e tyre për ta shfrytëzuar atë, do të binte ndesh me parimin e sigurisë juridike.

76. Në rastin *Mihalache* (§§ 117-125), Gjykata shqyrtoi një situatë ku një zyrë e lartë e prokurorisë kishte një mundësi për të shqyrtuar me propozimin e saj, në kontekstin e mbikëqyrjes hierarkike, meritat e vendimeve të marra nga një prokurori i një niveli më të ulët zyra dhe për ta anuluar atë. Gjykata vlerësoi se një mundësi për të rihapur procedurat dhe për të rishqyrtuar meritat e një vendimi pa u lidhur me ndonjë afat nuk përbënte një "mjet të rregullt juridik" dhe kështu nuk ndikoi në çështjen e plotfuqishmërisë së vendimit të marrë nga prokuroria e nivelit më të ulët.
77. Duhet të vihet në dukje se, në disa raste që kanë të bëjnë me dy grupe paralele të procedimeve, çështja nëse një procedurë është "e plotfuqishme" ose jo mund të jetë pa rëndësi nëse nuk ka dyfishim të vërtetë të procedurave, por më tepër një kombinim të procedimeve që konsiderohen të përbëjnë një tërësi të integruar (*Mihalache kundër Rumanisë* [DhM], 2019, § 82; *Johannesson dhe të tjerët kundër Islandës*, 2017, § 48). Në çështjen *Johannesson dhe të tjerët kundër Islandës*, 2017, Gjykata nuk e pa të nevojshme të përcaktonte nëse dhe kur grupi i parë i procedimeve - procedurat tatimore - u bënë të "plotfusishme" pasi kjo rrethanë nuk ndikoi në vlerësimin e marrëdhënies midis procedurave në fjalë. Sidoqoftë, në çështjen *Nodet kundër Francës*, 2019, § 46), Gjykata e konsideroi si të rëndësishme përcaktimin e momentit kur një grup procedimesh ishte bërë i plotfuqishëm. Në mënyrë të ngjashme, në çështjen *Korneyeva kundër Rusisë*, 2019, §§ 48 dhe 58, Gjykata shqyrtoi plotfuqishmërinë e dënimit paraprak të parashtruesit të kërkesës. Sidoqoftë, meqenëse ishte e qartë se të dy grupet e procedimeve nuk mund të konsideroheshin se formonin një përgjigje juridike të integruar ndaj sjelljes së parashtruesit të kërkesës, Gjykata nuk e konsideroi të rëndësishme të hyjë më tutje në çështjen e plotfuqishmërisë së grupit të parë të procedimeve dhe dyfishimit të ndjekjes penale.

III. Përrjashtimet

78. Neni 4 § 2 i Protokollit Nr. 7 përcakton një kufi në zbatimin e parimit të sigurisë juridike në çështjet penale. Kërkesat e sigurisë juridike nuk janë absolute, dhe në çështjet penale, ato duhet të vlerësohen në dritën e Nenit 4 § 2 të Protokollit Nr. 7, i cili lejon shprehimisht Shtetet Kontraktuese që të rihapin një rast kur dalin në pah fakte të reja, ose kur zbulohet një mangësi në procedurë (*Mihalache kundër Rumanisë* [DHM], 2019, § 129).
79. Neni 4 i Protokollit nr. 7 bën një dallim të qartë midis ndjekjes ose gjykimit rishtas të një personi, përçapje kjo e ndaluar nga paragrafi i parë, dhe rihapjes së procesit në rrethana të jashtëzakonshme, masë kjo e parashikuar në paragrafin e dytë, ku parashtrohet shprehimisht mundësia që një individ t'i duhet të përgjigjet përsëri për të njëjtat akuza,

në përputhje me të drejtën e brendshme, në qoftë se një çështje rihapet si pasojë e daljes së fakteve të reja apo e zbulimit të një mangësie themelore në procedurën e mëparshme.

80. Në çështjen *Nikitine kundër Rusisë*, 2014, paditësi ishte gjykuar për tradhti përmes spiunazhit dhe nxjerrjes në rrethana rënduese të sekreteve shtetërore. Ai ishte shpallur i pafajshëm me një vendim të formës së prerë të Gjykatës së Lartë. Kërkesa pasuese e Prokurorit të Përgjithshëm parashtruar Presidiumit të Gjykatës së Lartë rishqyrtimin e çështjes në kuadrin e procedurës për rishikim (e cila përfshinte një vlerësim të ri të ligjit të zbatueshëm si edhe të fakteve dhe provave që figuronin në dosje) si edhe kthimin e çështjes në hetuesi për rihapjen e hetimit, ishte hedhur poshtë. Gjykata ka vënë re se legjislacioni kombëtar e lejonte një rishqyrtim të tillë në qoftë se ky motivohej me frikën për ndonjë gabim gjyqësor rreth ndonjë pike juridike ose procedurale dhe se, kur kërkesa për rishikim deklarohej e pranueshme, rishikimi mund të shkonte deri në shfuqizimin e të gjitha vendimeve të mëparshme dhe të shprehej rreth akuzave penale me një vendim të ri. Ajo ka çmuar se, për këtë arsye, kjo mund të konsiderohej si një lloj i veçantë rihapjeje e procesit, që i takonte nenit 4 § 2 të Protokollit nr.7 (§§ 42-49, shih gjithashtu çështjet *Bratyakin kundër Rusisë* (vend.), 2006, *Fadin kundër Rusisë*, 2006, §§ 30-32, *Goncharovy kundër Rusisë* (vend.), 2018, *Savinski kundër Ukrainës* (vend.) 2005, *Xheraj kundër Shqipërisë*, 2008, §§ 71-74). Në vendimin e tij në çështjen *Korppoo kundër Finlandës*, 1995, Komisioni kishte thënë se, në mënyrë që prokuroria të mund të përcaktonte nëse kishte vend për të kërkuar rihapjen e çështjes, policia nuk duhej të pengohej në bazë të nenit 4 § 1 të Protokollit nr. 7 që t'i vazhdonte hetimet e saj pas shpalljes së pafajësisë për një të dyshuar.
81. Në rastin *Kadusic kundër Zvicrës*, 2018, parashtruesi i kërkesës ishte dënuar për vepra të ndryshme dhe po vuante një dënim me burg. Pas rivlerësimit të gjendjes mendore të parashtruesit të kërkesës, gjykata vendore urdhëroi një masë terapeutike institucionale, përkatësisht një ndryshim të dënimit pas dhënies së aktgjykimit fillestar dhe gjatë kohës së dënimit pasues, dhe pezulloi gjatësinë e dënimit të mbetur të cilin parashtruesi ende duhej të vuante. Kjo masë terapeutike u bazua në sëmundjen e rëndë mendore të parashtruesit të kërkesës që tashmë ishte e pranishme, por nuk u zbulua në kohën e gjykitimit fillestar. Gjykata konstatoi që masa nuk shkelte Nenin 4 të Protokollit Nr. 7. Autoritetet vendore e kishin parë rivlerësimin e gjendjes mendore të parashtruesit të kërkesës si një rrethanë e sapo zbuluar dhe kishin ndryshuar aktgjykimin origjinal duke zbatuar rregullat e rishikimit me analogji . Gjykata vuri në dukje se parashtruesi i kërkesës nuk kishte shpjeguar në çfarë kuptimi rihapja e çështjes nuk kishte ndodhur “në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të Shtetit në fjalë” (§ 85).
82. Në rastin *W.A. kundër Zvicrës*, 2021, (në lidhje me paraburgimin e mëvonshëm parandalues të parashtruesit të kërkesës të urdhëruar në rihapjen e procedurës për shkak të shëndetit mendor të parashtruesit të kërkesës dhe rrezikut për të përsëritur veprën penale), Gjykata sqaroi se një "rihapje", për qëllimet e nenit 4 § 2 të Protokollit nr. 7, zakonisht çon në anulimin e vendimit fillestar të gjykatës penale dhe ricaktimin e kallëzimit penal me një vendim të ri. Prandaj, në rrethanat kur rihapja nuk kërkon ndonjë element të ri që ndikon në natyrën e veprave të kryera nga parashtruesi i kërkesës ose në shkallën e fajit të tij dhe nuk është ose nuk do të bëhet një përcaktim i ri i një kallëzimi penal, nuk mund të ketë “rihapje” sipas kuptimit të nenit 4 § 2 të Protokollit nr. 7, dhe për rrjedhojë, dënimi i ri i urdhëruar për të njëjtën vepër përbën një shkëlqje të nenit 4 të Protokollit nr. 7 (po aty, §§ 71-72; shih gjithashtu § 42 në lidhje me ndërveprimin me nenin 5 § 1 dhe lidhjen e kërkuar shkakësore ndërmjet dënimit fillestar dhe paraburgimit të ri të urdhëruar në procedurën e rihapur).
83. Në rastin *Mihalache kundër Rumanisë* [DhM], 2019, § 131-133, Gjykata sqaroi konceptet e fakteve të reja ose të zbuluara rishtas ose zbulimin e një mangësie themelor në procedurat e mëparshme. Ajo shpjegoi se ato janë kushte alternative dhe jo kumulative.

84. Në veçanti, rrethanat në lidhje me çështjen që ekzistojnë gjatë gjykimit, por mbesin të pashpalosura nga gjyqtari dhe bëhen të njohura vetëm pas gjykimit, janë “ rishtazi të zbuluara”. Rrethanat që kanë të bëjnë me çështjen, por lindin vetëm pas gjykimit janë “të reja”. Për më tepër, shprehja “fakte të reja ose të zbuluara rishtazi” përfshijnë provat e reja në lidhje me faktet ekzistuese të mëhershme.
85. Koncepti i “mangësisë themelore” brenda kuptimit të Nenit 4 § paragrafi 2 të Protokollit Nr. 7, sugjeron që vetëm një shkelje serioze e një rregulli procedural që cenon rëndë integritetin e procedurës së mëparshme mund të shërbejë si bazë për rihapjen e kësaj të fundit në dëm të të akuzuarit, ku ai ose ajo është shpallur i pafajshëm nga një vepër penale ose është ndëshkuar për një vepër më pak të rëndë se ajo e parashikuar nga ligji në fuqi. Si pasojë, në raste të tilla, një rivlerësim i thjeshtë i provave në shkresat e lëndës nga prokurori publik ose gjykata e nivelit më të lartë nuk do të përmbushte atë kriter. Sidoqoftë, në lidhje me situatat kur një i akuzuar është shpallur fajtor dhe një rihapje e procedurave mund të funksionojë në favor të tij, Neni 4 i Protokollit Nr. 7 nuk parandalon një rihapje të procedurave në favor të personit të dënuar dhe çfarëdo ndryshimi tjetër të aktgjykimit në dobi të personit të dënuar. Në situata të tilla, për këtë arsye, natyra e mangësisë duhet të vlerësohet kryesisht për të konstatuar nëse ka pasur shkelje të të drejtave të mbrojtjes dhe si pasojë e kësaj një pengesë për administrimin e duhur të drejtësisë.
86. Së fundmi, Gjykata shpjegoi se në të gjitha rastet, arsyet që justifikojnë rihapjen e procedimeve duhet, në përputhje me nenin 4 § 2 të Protokollit Nr. 7 shkurtimisht, të jenë të tilla që të “ndikojnë në rezultatin e çështjes” ose në favor të personit ose në dëm të tij ose të saj.
87. Kundër parimeve të mësipërme, në çështjen *Mihalache* (§§ 134-138), Gjykata nuk e pranoi argumentin e Qeverisë se nevoja për të harmonizuar praktikën prokuroriale binte nën rrethanat e jashtëzakonshme të referuara në Nenin 4 § 2 të Protokollit Nr. 7, e as nuk konsideroi se një rivlerësim i thjeshtë i fakteve në dritën e ligjit në fuqi përbënte një “mangësi themelore” në procedurën e mëparshme. (shih gjithashtu *Stävila kundër Rumanis*, 2022, §§ 88-102).
88. Në rastin *Sabalić kundër Kroacisë*, 2021, § 114, Gjykata konsideroi (në kontekstin e shqyrtimit të pajtueshmërisë së mangët me detyrimin procedural sipas neneve 3 dhe 14 të Konventës në një çështje në lidhje me dhunën homofobike) se si dështimi për të hetuar motivet e urrejtjes pas një sulmi të dhunshëm dhe mosmarrja në konsideratë e motiveve të tilla në përcaktimin e dënimit për krimet e dhunshme të urrejtjes, përbënin "defekte themelore" në procedurat sipas nenit 4 § 2 të Protokollit nr. 7, duke lejuar kështu rihapjen e tyre në dëm të të akuzuarit. Në rrethana të tilla, parimi *ne bis in idem* nuk mund të përbëjë pengesë *de jure* për rishqyrtimin e çështjes në përputhje me standardet e Konventës.

Aplikimi i parimeve të përgjithshme (ne bis in idem) në kontekst të Ligjit të kontestuar dhe rasteve të bashkuara KO192/23 dhe KO229/23

89. Vërej se nenet 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] dhe 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës përcaktojnë se KEDNJ-ja është drejtpërdrejtë e zbatueshme dhe ka përparësi ndaj ligjeve vendore të Republikës së Kosovës dhe se të drejtat dhe liritë themelore të njeriut duhet të interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të GJEDNJ-së.

F) Vlerësimi i kushtetutshmërisë së paragrafit 2 të nenit 4 (Ne Bis In Idem) në kontekst të hedhjes së aktakuzës, përkatësisht ndryshimit të vendimit të formës së

prerë me të cilin përfundon procedura penale në rastet e bashkuara KO192/23 dhe KO229/23

90. Vërej më tej se Gjykata referuese kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së par. 2 të nenit 4 (Ne Bis In Idem) të ligjit të kontestuar, i cili përcakton “2. *Me përjashtim të rasteve kur me këtë Kod është paraparë ndryshe, vendimi gjyqësor i formës së prerë mund të ndryshohet me mjete të jashtëzakonshme juridike*”.
91. Më tej, rikujtoj se neni 4 i Protokollit 7 përcakton
- “1. Askush nuk mund të ndiqet ose të dënohet penalisht nga juridiksioni i të njëjtit Shtet për një vepër për të cilën ai më parë ka qenë shpallur i pafajshëm ose dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë, në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të atij Shteti.*
- 2. Dispozitat e paragrafit të mësipërm nuk pengojnë rihapjen e procesit, në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të Shtetit të interesuar, në rast se fakte të reja ose të zbuluara rishtazi, ose një mangësi themelore në procedimet e mëparshme janë të një natyre të tillë që mund të cenojnë vendimin e dhënë.*
- 3. Asnjë derogim nuk lejohet për këtë nen në përputhje me nenin 15 të Konventës.”*
92. Vërej se paragrafi 2 i nenit 4 të Protokollit 7 të KEDNJ-së parashikon përjashtime të cilat “nuk pengojnë rihapjen e procesit, në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të Shtetit të interesuar, në rast se fakte të reja ose të zbuluara rishtazi, ose një mangësi themelore në procedimet e mëparshme janë të një natyre të tillë që mund të cenojnë vendimin e dhënë”.
93. Vërej se paragrafi 2 i nenit 4 të Protokollit 7 të KEDNJ-së nuk pengon që “vendimi gjyqësor i formës së prerë mund të ndryshohet me mjete të jashtëzakonshme juridike”, nëse kjo parashihet me ligjin e vendit përkatës.
94. Bazuar në sa më sipër, konkludoj se paragrafi 2 i nenit 4 (Ne Bis In Idem) të ligjit të kontestuar, i cili përcakton: “2. *Me përjashtim të rasteve kur me këtë Kod është paraparë ndryshe, vendimi gjyqësor i formës së prerë mund të ndryshohet me mjete të jashtëzakonshme juridike*”, nuk është në kundërshtim me nenin 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër] të Kushtetutës në lidhje me nenin 4 (2) (E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë) të Protokollit nr. 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

G) Vlerësimi i kushtetutshmërisë së paragrafit 2 të nenit 438 (Aktgjykimi mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë) në kontekst të hedhjes së aktakuzës, përkatësisht ndryshimit të vendimit të formës së prerë me të cilin përfundon procedura penale në rastet e bashkuara KO192/23 dhe KO229/23

95. Duke iu rikthyer rastit konkret, rikujtoj se Gjykata referuese në rastin KO192/23 konsideron se Gjykata Kushtetuese duhet të sqarojë tri (3) gjëra të rëndësishme, dhe ato janë: (i) së pari, çfarë nënkuptohet me termin e përdorur nga legjislacioni “*qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë*”, pasi kjo mund të shkaktojë paqartësi në interpretim; (ii) së dyti, si duhet të veprojë gjykata pasi ka konstatuar se bëhet fjalë për një “*vendim qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë*”, pasi kjo nuk sqarohet nga kjo dispozitë ligjore dhe (iii) së treti, kjo mënyrë e vendosjes në dëm të të pandehurit, sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë së Kryeprokurorit të Shtetit, me mjet të jashtëzakonshëm juridik, a është në përputhje me parimet dhe dispozitat kushtetuese, si dhe me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

96. Më tej, Gjykata referuese në kërkesën KO229/23 thekson se “në rastin konkret ndaj aktvendimit të formës së prerë, përveç mbrojtësve të të pandehurve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kishte ushtruar edhe prokurori i shtetit, duke pasur parasysh se në kërkesë propozoi që për shkak të “gabimeve të rënda” lënda të kthehet në rivendosje, pyetja që parashtrohet është se a mund të ndryshohet vendimi i formës së prerë me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si mjet i jashtëzakonshëm juridik në dëm të të pandehurve dhe a janë dispozitat e nenit 4 par. 2 dhe nenit 438 par. 2 të KPP-së në përputhshmëri me nenet 30, 31, 34 dhe 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës”.
97. Duke iu kthyer parimeve të përgjithshme, Gjykata rikujton se neni 4 përmban tre paragrafë. Paragrafi i parë parashtron tre elemente përbërëse kyç të parimit *ne bis in idem* (*Mihalache kundër Rumanisë* [DHM], 2019, par. 49):
- a. a kanë qenë të dy procedurat me natyrë “penale”,
 - b. a kishin të bëjnë të dy procedurat me të njëjtën vepër, dhe
 - c. A ka ardhur deri te dyfishimi i procedurës.

Elementi i tretë përbërës përfshin tri elemente të tjera të veçanta:

- i. a ka pasur procedura të reja
 - ii. nëse po, a ka përfunduar grupi i parë i procedurave me një vendim të formës së prerë; dhe
 - iii. a është i aplikueshëm përjashtimi i cekur në paragrafin e dytë.
98. Duke i aplikuar më tej parimet e përgjithshme në rastet e bashkuara konkrete KO192/23 dhe KO229/23, vërej se nuk është kontestues komponenti i parë kyç, përkatësisht se procedurat janë të natyrës “penale”.
99. Më tej, vërej se për parashtruesit e kërkesës, përkatësisht gjykatat referuese nuk është kontestues as komponenti i dytë kyç, se bëhet fjalë për të dy procedurat për veprën e njëjtë.
100. Për parashtruesit e kërkesës është kontestues komponenti i tretë kyç, përkatësisht nëse me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë në pajtim me paragrafin 2 të nenit 438 (Aktgjykimi mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë) ka ardhur deri te dyfishimi i procedurës. Më tej rikujtoj se komponenti i tretë kyç përbëhet nga tri nën-pyetje, në të cilat Gjykata duhet të përgjigjet.
101. Në kontekst të hedhjes poshtë të aktakuzës, përkatësisht ndryshimit të vendimit të formës së prerë me të cilin përmbillet procedura penale në rastet e bashkuara KO192/23 dhe KO229/23, duhet të përcaktohet nëse me aplikimin e paragrafit 2 të nenit 438 (Aktgjykimi mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë), i cili përcakton “2. Kur Gjykata Supreme e Kosovës çmon se kërkesa e paraqitur për mbrojtjen e ligjshmërisë në dëm të të pandehurit është e bazuar, vetëm konstaton shkeljen e ligjit pa ndikuar në vendimin e formës së prerë, përveç nëse vendimi i formës së prerë është qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë,” ka ardhur deri te shkelja e parimit “*Ne Bis In Idem*” i cili përcaktohet me nenin 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër] të Kushtetutës në lidhje me nenin 4 (2) (E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë) të Protokollit nr. 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
102. Për të arritur deri te kjo përgjigje, Gjykata duhet të bëjë testin për komponentin e tretë, gjegjësisht të përgjigjet nëse me formulimin “*përveç nëse vendimi i formës së prerë është qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë*” ka ardhur deri te

- i.rihapja e procedurave të reja;
- ii.nëse po, a ka përfunduar grupi i parë i procedurave me vendim të formës së prerë;
- iii. a është i aplikueshëm përjashtimi nga paragrafi i dytë.

103. Vërej se sa i përket nën-pyetjes së parë i) se a do të vijë deri te rihapja e procedurave të reja, përkatësisht a është e mundur rihapja e procedurave të reja në bazë të formulimit “*përveç nëse vendimi i formës së prerë është qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë*” dhe në bazë të paragrafit 2 të nenit 438 (Aktgjykimi mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë)
104. Përgjigja në këtë pyetje të testit është PO sepse parashihet mundësia e ndryshimit të vendimit të formës së prerë madje edhe në dëm të të pandehurit nëse vendimi i formës së prerë “*është qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë*”.
105. Pyetja tjetër që bëhet në Gjykatë është ii) a është përmbyllur grupi i parë i procedurave me vendim të formës së prerë, përkatësisht nëse vendimi i gjykatave të instancës më të ulët është bërë i formës së prerë para zbatimit të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë si mjet i jashtëzakonshëm juridik.
106. Sa i përket hedhjes së aktakuzës, Gjykata rikujton se në rastin *Mihalache* (§§ 99-101), Gjykata iu referua faktit se sipas të drejtës së brendshme zyra e prokurorit publik u thirr për të marrë pjesë në administrimin e drejtësisë penale. Prokurori kishte juridiksionin për të hetuar veprimet e pretenduara të parashtruesit të kërkesës, duke marrë në pyetje një dëshmitar dhe të dyshuarin për këtë qëllim. Më pastaj, ai i zbatoi rregullat përkatëse materiale të përcaktuara në ligjin vendor; ai duhej të vlerësonte nëse ishin përmbushur kërkesat për cilësimin e veprimeve të pretenduara të parashtruesit të kërkesës si një vepër penale. Në bazë të provave të nxjerra, prokurori bëri vlerësimin e tij për të gjitha rrethanat e çështjes, në lidhje me parashtruesin e kërkesës individualisht dhe me gjendjen faktike specifike. Pas kryerjes së këtij vlerësimi, duke vepruar përsëri në përputhje me kompetencat e dhëna atij sipas drejtës së brendshme, prokurori vendosi të ndërpresë ndjekjen penale, ndërsa shqiptoi një dënim ndaj parashtruesit të kërkesës që kishte një qëllim ndëshkues dhe parandalues. Dënimi i vënë u bë i zbatueshëm me mbarimin e afatit kohor për ankesë nga ana e parashtruesit të kërkesës sipas drejtës së brendshme. Në këto rrethana, Gjykata gjeti se, pavarësisht nga çdo përfshirje gjyqësore, vendimi i prokurorit arrinte masën e një “aktgjykimi dënues” brenda kuptimit të nenit 2 të Protokollit Nr. 7.
107. Përkitazi me ndryshimin e vendimit të formës së prerë me të cilin përmbillet procedura penale, rikujtoj parimet e përgjithshme se qëllimi i nenit 4 të Protokollit nr. 7 ka për objekt që ta ndalojë përsëritjen e procedurave penale (parimi *ne bis in idem*) të përfunduara me vendim të formës së prerë. Sipas raportit shpjegues rreth Protokollit nr. 7, raport që i referohet nga ana e tij Konventës Evropiane rreth Vlefshmërisë Ndërkombëtare të Vendimeve Penale, një vendim është i formës së prerë në qoftë se ai, sipas shprehjes tradicionale, e ka marrë fuqinë *res judicata*. I tillë është rasti kur ai është i parevokueshëm, domethënë kur kundër tij nuk ka më mundësi mjetesh të rregullta ligjore ose kur palët i kanë shteruar këto mjete apo i kanë lënë afatet të kalojnë pa i ushtruar ato (*Sergey Zolotoukhin kundër Ruisë* [DHM], 2009, § 107). Vendimet kundër të cilave ka mundësi mjetesh të rregullta juridike nuk përfitojnë nga garancia që përmban neni 4 i Protokollit nr. 7 për aq kohë sa nuk ka përfunduar afati i apelimit (§ 108). Nga ana tjetër, mjetet e jashtëzakonshme juridike, siç është kërkesa për rihapje të procedurës apo ndonjë kërkesë për zgjatje të një afati të përfunduar, nuk merren fare parasysh kur është fjala për të përcaktuar nëse procedura ka përfunduar me vendim të formës së prerë apo jo. Edhe pse këto mjete ligjore përfaqësojnë një vazhdim të procedurës së parë, karakteri “i formës së prerë” të vendimit nuk varet nga ushtrimi i tyre (§ 108).

108. Përgjigja në këtë pyetje të testit është PO sepse parashihet ndryshimi i vendimit të formës së prerë madje edhe në dëm të të pandehurit, përveç nëse vendimi i formës së prerë është “qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë”.
109. Në fund, duhet të përgjigjet edhe në nën-pyetjen e tretë të komponentit të tretë kyç që është iii) a është i aplikueshëm përjashtimi nga paragrafi 2 i nenit 4 të Protokollit 7, i cili përcakton: “2. Dispozitat e paragrafit të mësipërm nuk pengojnë rihapjen e procesit, në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të Shtetit të interesuar, në rast se fakte të reja ose të zbuluara rishtazi, ose një mangësi themelore në procedimet e mëparshme janë të një natyre të tillë që mund të cenojnë vendimin e dhënë”.
110. Për t’iu përgjigjur kësaj pyetje, Gjykata është dashur të shikojë Kodin Nr. 08/L-032 për Procedurën Penale të Republikës së Kosovës në tërësi.
111. Fillimisht, vërej se në pajtim me Kodin Nr. 08/L-032 për Procedurën Penale të Republikës së Kosovës ekzistojnë dy mjete të jashtëzakonshme juridike, siç përcaktohet me nenin 419 të Kodit.

Neni 419 **Mjetet e jashtëzakonshme juridike**

“1.Procedura penale e përfunduar me aktvendim të formës së prerë ose me aktgjykim të formës së prerë mund të rishikohet me kërkesën e personave të autorizuar vetëm në rastet dhe sipas kushteve të parapara me këtë Kod. Kërkesa për rishikim të procedurës penale i paraqitet gjykatës themelore e cila ka nxjerr vendimin.

2. Pala mund të kërkojë zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit në çdo kohë gjatë periudhës së mbajtjes së dënimit. Pala i paraqet kërkesën gjykatës themelore e cila ka nxjerr aktgjykimin në shkallë të parë, e cila ia përcjell të gjitha shkresat e lëndës Gjykatës Supreme.

3. Pala mund të paraqesë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë brenda tre (3) muajsh nga dita kur është dorëzuar aktgjykimin i formës së prerë ose aktvendimi i formës së prerë kundër të cilit kërkohet mbrojtja e ligjshmërisë. Pala paraqet kërkesën në gjykatën themelore e cila ka nxjerr vendimin në shkallë të parë, e cila ia përcjell të gjitha shkresat e lëndës Gjykatës Supreme.

4. Nenet 375, 376, 377, 378 dhe 379 të këtij Kodi zbatohen për të gjitha kërkesat nga ky nen.”

112. Vërej më tej se në bazë të nenit 422 është i mundur Rishikimi i procedurës penale të pushuar me aktvendim të formës së prerë, ndërsa në bazë të nenit 423 është i mundur rishikimi i procedurës penale të përfunduar me aktgjykim të formës së prerë, të cilët përcaktojnë

Neni 422 **Rishikimi i procedurës penale të pushuar me aktvendim të formës së prerë**

“1. Procedura penale e pushuar në formë të prerë para fillimit të shqyrtimit gjyqësor mund të rishikohet kur prokurori i shtetit tërhiqet nga aktakuza dhe vërtetohet se tërheqja është pasojë e veprës penale të kryer nga prokurori i shtetit. Gjatë provimit të veprës penale zbatohen dispozitat nga neni 423, paragrafi 3 i këtij Kodi.

2. Kur aktakuza hidhet bazuar në mungesë provash të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale të përshkruar në aktakuzë dhe nëse zbulohen dhe mbledhen fakte dhe prova të reja, mund të ngritet aktakuzë e re kur kolegji shqyrtues vendos se provat dhe faktet e reja e arsyetojnë këtë.”

Neni 423

Rishikimi i procedurës penale të përfunduar me aktgjykim të formës së prerë

“1. Procedura penale e përfunduar me aktgjykim të formës së prerë mund të rishikohet vetëm:

1.1. provohet se aktgjykimi është mbështetur në dokument të falsifikuar ose në deklaram të rremë të dëshmitarit, ekspertit ose përkthyesit;

1.2. provohet se aktgjykimi është pasojë e veprës penale të kryer nga gjyqtari ose personi që ka ndërmarrë veprimet hetimore;

1.3. zbulohen fakte të reja ose paraqiten prova të reja, të cilat vetë ose së bashku me provat e mëparshme ka të ngjarë të arsyetojë pafajësinë e personit të dënuar ose dënimit e tij sipas një dispozite më të butë penale;

1.4. personi për të njëjtën veprë është gjykuar disa herë ose kur disa persona janë dënuar për veprë të njëjtë të cilën ka mund ta kryejë vetëm një person ose disa prej tyre; ose

1.5. në rastin e dënimit për veprë penale në vazhdim ose vepra tjera penale të cilat sipas ligjit përfshijnë disa veprime të njëjta ose të ndryshme, zbulohen fakte të reja ose paraqiten prova të reja që tregojnë se i dënuari nuk ka kryer veprimin që është përfshirë në veprën penale për të cilën ai është dënuar dhe ekzistimi i fakteve të tilla do të ishte me ndikim vendimtar në caktimin e dënimit.

2. Procedura penale e përfunduar me aktgjykim të formës së prerë mund të rishikohet vetëm në favor të të pandehurit, përveç nëse vërtetohet që rrethanat nga paragrafi 1 nën-paragrafët 1.1 dhe 1.2 të këtij neni janë pasojë e veprës penale të kryer nga i pandehuri ose personi që vepron në emër të tij kundër një dëshmitari, eksperti, përkthyesi, prokurori të shtetit ose gjyqtari apo të afërmeve të tyre, me ç'rast procedura penale e përfunduar me aktgjykim të formës së prerë mund të rishikohet kundër të pandehurit. Rishikimi i procedurës penale në dëm të pandehurit lejohet vetëm brenda pesë (5) vjetëve nga koha e shpalljes së aktgjykimit të formës së prerë.

3. Në rastet nga paragrafi 1 nën-paragrafi 1.1 dhe 1.2 ose paragrafit 2 i këtij neni, me aktgjykim të formës së prerë duhet vërtetuar se personat e tillë a janë shpallur fajtor për veprat penale përkatëse. Kur procedura kundër këtyre personave nuk mund të zbatohet për shkak se kanë vdekur ose ekzistojnë rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale, faktet nga paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe 1.2 ose paragrafi 2 i këtij neni mund të vërtetohen edhe me prova të tjera.”

113. Vërej më tej se Ligji përmes nenit 424 rregullon “Personat e autorizuar për të kërkuar rishikimin e procedurës penale”, pastaj me nenin 425 rregullohet “Përmbajtja e kërkesës për rishikim të procedurës penale dhe gjykata që vendos për të”, ndërsa përmes nenit 426 rregullohet “Baza dhe procedura për hedhjen e kërkesës për rishikim të procedurës penale”, me nenin 427 rregullohen “Vendimet e kolegjit lidhur me kërkesën për rishikim” dhe në fund me nenin 428 “Rregullat për procedurën e re të rishikimit”.

Neni 424

Personat e autorizuar për të kërkuar rishikimin e procedurës penale

“1. Rishikimin e procedurës penale mund ta kërkojnë palët dhe mbrojtësi. Pas vdekjes së të dënuarit, rishikimin mund ta kërkojë prokurori i shtetit, bashkëshorti, bashkëshorti jashtëmartesor, personi në gjini gjaku në vijë direkte deri në shkallë të parë, prindi adoptues, fëmija i adoptuar, vëllai, motra ose prindi birësues i të dënuarit.

2. Rishikimi i procedurës penale mund të kërkohet edhe pasi i dënuari mban dënimin, pavarësisht nga afati i parashkrimit, amnistisë ose faljes.

3. Kur gjykata kompetente për të vendosur mbi rishikimin e procedurës penale mëson se ekzistojnë shkaqe për rishikimin e procedurës penale, për këtë e njofton të dënuarin apo personin e autorizuar për paraqitje të kërkesës.”

Neni 425

Përmbajtja e kërkesës për rishikim të procedurës penale dhe gjykata që vendos për të

“1. Kërkesa për rishikimin e procedurës penale vendoset nga kolegji shqyrtues i gjykatës themelore e cila ka gjykuar në procedurën e mëparshme.

2. Në kërkesë duhet shënuar bazën ligjore sipas së cilës kërkohet rishikimi, si dhe provat me të cilat argumentohen faktet në të cilat mbështetet kërkesa. Nëse kërkesa nuk i përmban këto të dhëna, gjykata e thërret parashtruesin që brenda afatit të caktuar të plotësojë kërkesën.

3. Me rastin e vendosjes së kërkesës për rishikim, në kolegji nuk merr pjesë gjyqtari i cili ka marrë pjesë në marrjen e aktgjykimit në procedurën e mëparshme.”

Neni 426

Baza dhe procedura për hedhjen e kërkesës për rishikim të procedurës penale

“1. Gjykata me aktvendim hedh kërkesën kur në bazë të saj dhe shkresave të procedurës së mëparshme vërteton se:

1.1. kërkesën e ka parashtruar personi i paautorizuar;

1.2. nuk ka bazë ligjore për rishikim të procedurës;

1.3. faktet dhe provat në të cilat mbështetet kërkesa janë paraqitur në kërkesën e mëparshme për rishikim të procedurës e cila është refuzuar me aktvendim të formës së prerë;

1.4. faktet dhe provat nuk ofrojnë arsye për lejim të rishikimit të procedurës; ose

1.5. parashtruesi i kërkesës për rishikim të procedurës nuk ka vepruar sipas nenit 425, paragrafi 2 të këtij Kodi.

2. Kur gjykata nuk e hedh kërkesën, kopja e kërkesës i dërgohet prokurorit të shtetit ose palës tjetër, e cila ka të drejtë që brenda tetë (8) ditëve të përgjigjet në kërkesë. Pasi gjykata të merr përgjigje në kërkesë ose kur kalon afati për paraqitjen e përgjigjes, kryetari i kolegjit shqyrtues urdhëron gjurmimin dhe shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura në kërkesë dhe në përgjigje.”

Neni 427

Vendimet e kolegjit lidhur me kërkesën për rishikim

“1. Bazuar në rezultatet e gjurmimit dhe shqyrtimit të fakteve dhe provave të paraqitura në kërkesë dhe në përgjigje, gjykata aprovon kërkesën dhe lejon rishikimin e procedurës penale ose e refuzon kërkesën.

2. Kur gjykata çmon se shkaqet për të cilat ka lejuar rishikimin e procedurës janë edhe në dobi të një të bashkakuzuari i cili nuk ka paraqitur kërkesë për rishikim të procedurës, vepron sipas detyrës zyrtare sikur kërkesa e tillë të ishte paraqitur.

3. Në aktvendim me të cilin lejohet rishikimi i procedurës penale, gjykata urdhëron caktimin e menjëhershëm të shqyrtimi të ri gjyqësor ose kthimin e çështjes në fazën e hetimit, apo fillimin e hetimit kur hetimi nuk është zbatuar më parë.

4.1. Gjykata urdhëron që ekzekutimi i aktgjykimit të shtyhet ose të ndërpritet nëse duke u bazuar në provat e paraqitura çmon se:

llogaritjes së dënimit të mbajtur do të duhej të lirohet;

4.2. ai mund të lirohet nga akuza; ose

4.3. akuza e ngritur kundër tij mund të refuzohet.

5. Kur aktvendimi me të cilin lejohet rishikimi i procedurës penale merr formë të prerë, atëherë pushohet ekzekutimi i dënimit. Por, nëse ekzistojnë kushtet nga neni 184 paragrafi 1 i këtij Kodi, gjykata cakton paraburgimin.”

Neni 428

Rregullat për procedurën e re të rishikimit

“1. Për procedurën e re që zbatohet në bazë të aktvendimit me të cilin lejohet rishikimi i procedurës penale vlejnë dispozitat e njëjta si ato të procedurës së mëparshme. Në procedurën e re, gjykata nuk detyrohet me aktvendimet e marra në procedurën e mëparshme.

2. Në qoftë se procedura e re pushohet para fillimit të shqyrtimit gjyqësor, aktgjykimi i mëparshëm anulohet me aktvendimin mbi pushimin e procedurës.

3. Me rastin e marrjes së aktgjykimit të ri, gjykata anulon aktgjykimin e mëparshëm apo vetëm një pjesë të tij, ose e lë në fuqi aktgjykimin e mëparshëm. Në dënim të shqiptuar me aktgjykim të ri, gjykata i llogarit të akuzuarit dënimin e mbajtur, e kur lejohet rishikimi vetëm për ndonjë vepër për të cilën i akuzuari ka qenë i dënuar ose i liruar, gjykata shqipton dënim të ri unik sipas dispozitave të Kodit Penal.

4. Gjykata në procedurën e re detyrohet me ndalesën e paraparë në nenin 395 të këtij Kodi.”

114. Bazuar në normat e sipërpërmendura, konkludohet se këto zgjidhje ligjore mbulojnë plotësisht përjashtimet e renditura në parimet e përgjithshme dhe ofrojnë një mundësi të saktë dhe precize për të lejuar, si përjashtim, rishikimin e procedurave penale tashmë të përfunduara në pajtim me paragrafin 2 të nenit 4 të Protokollit 7 i KEDNJ-së.

115. Nga sa më sipër, konstatoj se nenet e lartpërmendura që kanë të bëjnë me mjetin e jashtëzakonshëm juridik kërkesë për përsëritje të procedurës penale janë në përputhje me përjashtimet e parashikuara me paragrafin 2 të nenit 4 të Protokollit 7 i KEDNJ-së dhe përgjigjja në këtë nën-pyetjen e tretë të komponentit të tretë kyç është PO sa i përket këtij mjeti të jashtëzakonshëm juridik.

116. Më tej, vërej se Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës nr. 08/L-032 ka paraparë mundësinë edhe të një mjeti tjetër të jashtëzakonshëm juridik, gjegjësisht kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, me të cilën po ashtu është e mundur të ndryshohet me mjet të jashtëzakonshëm juridik “vendimi i formës së prerë” të gjykatave të instancave më të ulëta.
117. Ligji e parashikon këtë mundësi në nenin 432, i cili parasheh “Arsyet për paraqitje të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë”, ndërsa në nenin 438 të kontestuar, parashikon se çfarë mund të jetë Aktgjykimi mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, të cilët përcaktojnë;

Neni 432
Arsyet për paraqitje të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë

“1. Kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë ose kundër procedurës gjyqësore e cila i ka paraprirë marrjes së vendimit të tillë, pas përfundimit të procedurës penale në formë të prerë mund të paraqitet kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në rastet vijuese:

1.1. në rast të shkeljes së ligjit penal;

1.2. në rast të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafit 1 i këtij Kodi; ose

1.3. në rast të shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor.

2. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, as kundër vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës me të cilën është vendosur mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.

3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, Kryeprokurori i Shtetit mund të paraqesë kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë për cilëndo shkelje ligjore.

4. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqitet, gjatë procedurës e cila nuk ka përfunduar në formë të prerë, vetëm kundër vendimeve të formës së prerë lidhur me caktimin, vazhdimin ose ndërprerjen e paraburgimit.”

Neni 438
Aktgjykimi mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë

“1. Kur Gjykata Supreme e Kosovës vërteton se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar, merr aktgjykim me të cilin, duke pasur parasysh llojin e shkeljes:

1.1. ndryshon vendimin e formës së prerë;

1.2. në tërësi ose pjesërisht anulon vendimin e gjykatës themelore dhe të gjykatës më të lartë ose vetëm vendimin e gjykatës më lartë dhe lëndën për vendim të ri mbi meritat ose për rigjykim ia kthen gjykatës themelore ose gjykatës më të lartë; ose

1.3. kufizohet vetëm në vërtetimin e shkeljes së ligjit.

2. Kur Gjykata Supreme e Kosovës çmon se kërkesa e paraqitur për mbrojtjen e ligjshmërisë në dëm të të pandehurit është e bazuar, vetëm konstaton shkeljen e ligjit pa ndikuar në vendimin e formës së prerë, përveç nëse vendimi i formës së prerë është qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë.

3. Kur Gjykata e Apelit sipas këtij Kodi nuk ka pasur të drejtë ta mënjanojë shkeljen e ligjit e cila është bërë me vendim të shkallës së parë ose në procedurë gjyqësore që i ka paraprirë atij vendimi dhe Gjykata Supreme e Kosovës vërteton se kërkesa e paraqitur në dobi të të akuzuarit është e bazuar dhe se për mënjanimin e asaj shkelje duhet anuluar ose ndryshuar vendimin e shkallës së parë, Gjykata Supreme e Kosovës e anulon ose e ndryshon edhe vendimin e Gjykatës së Apelit, edhe pse me të nuk është shkelur ligji.”

118. Fillimisht vërej se në pajtim me paragrafin 2 të nenit 432 “Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, as kundër vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës me të cilën është vendosur mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë”.
119. Bazuar në këtë, konstatoj se ky mjet juridik nuk bie në përjashtimin e kërkuar me paragrafin 2 të nenit 4 të Protokollit 7 të KEDNJ-së sepse kërkon zbulimin e provave të reja, përkatësisht fakteve të reja.
120. Rikujtoj se paragrafi 2 i nenit 4 të Protokollit 7 thekson “2. Dispozitat e paragrafit të mësipërm nuk pengojnë rihapjen e procesit, në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të Shtetit të interesuar, në rast se fakte të reja ose të zbuluara rishtazi, ose një mangësi themelore në procedimet e mëparshme janë të një natyre të tillë që mund të cenojnë vendimin e dhënë.”
121. Nga sa më sipër, konstatoj se nenet e lartpërmendura që kanë të bëjnë me mjetin e jashtëzakonshëm juridik kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë nuk janë në përputhje me përjashtimet e parashikuara me paragrafin 2 të nenit 4 të Protokollit 7 i KEDNJ-së dhe përgjigja në këtë nën-pyetjen e tretë të komponentit të tretë kyç është JO sa i përket këtij mjeti të jashtëzakonshëm juridik.
122. Vlerësoj se në rrethanat e rastit konkret, objekt vlerësimi kushtetues është çështja nëse Gjykata referuese mund të nxjerrë vendim që ndikon në të drejtat dhe liritë themelore të të pandehurit përmes kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë. Gjykata vlerëson se nga vet natyra e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë rrjedhë se kjo e fundit është vazhdimësi-ani pse është mjet i jashtëzakonshëm juridik- i të njëjtës procedurë penale të përfunduar me vendim të formës së prerë. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë kufizohet vetëm në shkaqe të shkeljes procedurale ligjore dhe nuk ka të bëjë me zbulimin e fakteve të reja të panjohura më parë apo me ndonjë defekt fundamental të procedurës së mëparshme penale, dhe si e tillë nuk bie në përjashtimet e parapara me paragrafin 2 të nenit 4 të Protokollit 7 të KEDNJ-së.
123. Rikujtoj se koncepti i “defektit fundamental” në kuptim të nenit 4 (2) të Protokollit Nr. 7 sugjeron që vetëm shkelja serioze e një rregulli procedural që rëndë e cenon integritetin e procedurave të mëparshme mund të shërbejë si bazë për rihapjen e këtyre të fundit në dëm të akuzuarit, ku ai ka qenë i liruar për një vepër penale ose i dënuar për një vepër penale më pak serioze sesa ka qenë e parashikuar me ligjin në fuqi. Rrjedhimisht, në raste të tilla, një vlerësim i thjeshtë i dokumenteve në dosje nga prokurori publik apo gjykata e nivelit të lartë nuk e përmbush atë kriter.
124. Më tej, vërej se neni 4 i Protokollit nr.7 nuk parandalon rihapjen e procedurës në dobi të personit të dënuar dhe ndonjë ndryshim tjetër të aktgjykimit në dobi të personit të dënuar. Në situata të tilla, natyra e defektit duhet të vlerësohet ashtu që konstatohet nëse ka pasur shkelje të të drejtave të mbrojtjes dhe rrjedhimisht pengesë në administrimin e duhur të drejtësisë. Po ashtu, në të gjitha rastet, baza për justifikimin e rihapjes së procedurës duhet, sipas Nenit 4 (2) të Protokollit Nr. 7, të jenë ashtu që të “ndikojnë në

rezultatit e rastit” (*affect the outcome of the case*) në dobi ose dëm të të akuzuarit. (shih rastin e GJEDNJ-së, [Mihalache kundër Rumanisë](#), cituar më lart, paragrafi 129).

125. Në këtë kontekst, vlerësoj se gjykatat e rregullta mund ta rihapin procedurën penale bazuar në paragrafin 2 të nenit 4 të Protokollit nr. 7 dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së. Veç kësaj, gjykatat e rregullta mund të rihapin procedurën penale bazuar në kushtet e përcaktuara taksativisht në nenin 423 (Rishikimi i procedurës penale me aktgjykim të formës së prerë) të Ligjit të kontestuar, që mes tjerash, përcakton se procedura penale mund të rihapet për shkak të falsifikimit të aktgjykimit, deklaratave të rreme, aktgjykimi është pasojë e veprës penale të gjyqtarit ose personit që ka ndërmarrë veprime hetimore, zbulohen fakte ose prova të reja lidhur me pafajësinë e personit të dënuar dhe rastet ku personi është gjykuar disa herë për të njëjtën veprë penale.
126. Duke shikuar veçoritë e mjeteve të jashtëzakonshme juridike, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë dhe rishikimi i procedurës penale me aktgjykim të formës së prerë, Gjykata vlerëson se: (i) mjeti i jashtëzakonshëm juridik-kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë paraqitet vetëm në rastet kur pretendohet se procesi penal është karakterizuar me shkelje procedurale; (ii) mjeti i jashtëzakonshëm juridik-rishikimi i procedurës penale me aktgjykim të formës së prerë paraqitet në rastet ku pretendohet se procesi penal është karakterizuar nga “defektet fundamentale”. Rrjedhimisht, konsideroj se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të përdoret për hapje të sërishme të çështjes penale të mbyllur. Procedura penale e mbyllur me vendim të formës së prerë mund të rihapet vetëm në rastet kur ka “gabime fundamentale” të cilat i parashikon me mjetin juridik të jashtëzakonshëm- rishikim i procedurës penale me aktgjykim të formës së prerë.
127. Më tej, rikujtoj edhe obligimet nga neni 440 Mbrojtja e të drejtave sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të cilat e obligojnë Republikën e Kosovës që *“Mjetet e jashtëzakonshme juridike sipas këtij Kapitulli mund të paraqiten në bazë të të drejtave të siguruara me këtë Kod dhe të mbrojtura me Kushtetutën e Republikës së Kosovës ose Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe protokollat e saj, si dhe me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”*
128. Duke pasur parasysh të gjitha këto dhe mundësinë e zbatimit të drejtpërdrejtë të paragrafit 2 të nenit 4 të Protokollit 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Gjykata vë në dukje edhe një herë përmbajtjen e paragrafit 2 të nenit 4 (Ne Bis In Idem). të ligjit të kontestuar, i cili thotë: *“2. Me përjashtim të rasteve kur me këtë Kod është paraparë ndryshe, vendimi gjyqësor i formës së prerë mund të ndryshohet me mjete të jashtëzakonshme juridike”*. Prandaj, duke qenë se ekziston mundësia e zbatimit të drejtpërdrejtë të paragrafit 2 të nenit 4 të Protokollit 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nuk shoh ndonjë arsye për ekzistencën e formulimit *“përveç nëse vendimi i formës së prerë është qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë”* nga paragrafi 2 i nenit 438 (Aktgjykimi mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë) të Kodit nr. 08/L-032 për procedurën penale, sepse gjykatat e rregullta mund të zbatojnë drejtpërdrejt përjashtimet e parapara në paragrafin 2 të nenit 4 të Protokollit 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
129. Me theks shtesë, vlerësoj se paragrafi 2 i nenit 4 (Ne Bis In Idem) i Ligjit të kontestuar nuk mund të përdoret në kontekst të paragrafit 2 të nenit 438 (Aktgjykimi mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë), përkatësisht, nuk mund të përdoret në kontekst të mjetit të jashtëzakonshëm juridik – kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, por vetëm në kontekst të mjetit të jashtëzakonshëm juridik – rishikimit të procedurës penale me aktgjykim të formës së prerë. Konsideroj se për qëllime të sigurisë juridike, Kosova nuk duhet të jetë i vetmi vend në Evropë që ka dy mjete të jashtëzakonshme juridike që mund të përdoren për rishikimin e aktgjykimit të formës së prerë në dëm të të pandehurit.

130. Bazuar në sa më sipër, konstatoj që formulimi “*përveç nëse vendimi i formës së prerë është qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë*” nga paragrafi 2 i nenit 438 (Aktgjykimi mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë) të Kodit nr. 08/L-032 të Procedurës Penale, nuk është në pajtim me nenin 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër] të Kushtetutës në lidhje me nenin 4 (2) (E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë) të Protokollit Nr. 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
131. Më tej, nuk do të lëshohem në vlerësimin e kushtetutshmërisë nëse formulimi “*përveç nëse vendimi i formës së prerë është qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë*” nga paragrafi 2 i nenit 438 (Aktgjykimi mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë) të Kodit nr. 08/L-032 të Procedurës Penale, është në pajtim me nenin 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës në lidhje me nenin 5 (E drejta për liri dhe siguri) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke pasur parasysh se tashmë kam arsyetuar se i njëjti nuk është në pajtim me nenin 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër] të Kushtetutës në lidhje me nenin 4 (2) (E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë) të Protokollit nr. 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

H) Përfundim në lidhje me shkeljet e pretenduara të Kushtetutës

132. Bazuar në sa më sipër, dhe duke marrë parasysh edhe shqyrtimin e pretendimeve të parashtruesit në kërkesën e tij:

- I. **PAJTOHEM** që Gjykata **TË DEKLAROJË** kërkesën të pranueshme;
- II. **PAJTOHEM QË** Gjykata **TË KONSTATOJË** se formulimi “ose ndërprerjen” i paragrafit 4 të nenit 432 (Arsyet për paraqitje së kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë) të Kodit nr. 08/L-032 të Procedurës Penale, nuk është në kundërshtim me pikën 2 të paragrafit 1 të nenit 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës në lidhje me nenin 5 (E drejta për liri dhe siguri) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- III. **PAJTOHEM QË** Gjykata **TË KONSTATOJË** se paragrafi 2 i nenit 4 (Ne Bis In Idem) i Kodit nr. 08/L-032 të Procedurës Penale nuk është në kundërshtim me nenin 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 2 të nenit 4 (E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë) të Protokollit nr. 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- IV. **PAJTOHEM QË** Gjykata është dashur **TË KONSTATOJË** se formulimi “përveç nëse vendimi i formës së prerë është qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë” i paragrafit 2 të nenit 438 (Aktgjykimi mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë) të Kodit nr. 08/L-032 të Procedurës Penale, nuk është në përputhshmëri me nenin 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër] të Kushtetutës në lidhje me nenin 4 (2) (E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë) të Protokollit nr. 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- V. **KONSIDEROJ QË** Gjykata është dashur **TË KONSTATOJË** se në pajtim me paragrafin 3 të nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, paragrafin 5 të nenit 20 (Vendimet) të Ligjit dhe paragrafin 4 të rregullit 60 (Zbatimi i Vendimeve) të Rregullores së punës, se formulimi “përveç nëse vendimi i formës së prerë është qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë” i paragrafit 2 të nenit 438 (Aktgjykimi mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë) i Kodit nr. 08/L-032 të Procedurës Penale, shfuqizohet në ditën e publikimit të aktgjykimit në Gazetën Zyrtare të Kosovës;

Mendimi konkurrues dhe mospajtues është paraqitur nga gjyqtari;

Radomir Laban, gjyqtar



Më 20 qershor 2024 në Prishtinë

